

**LIGJ**  
**I MENAXHIMIT TË PAKETIMIT DHE TË MBETURINAVE NGA PAKETIMI (\*)**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Lënda e rregullimit**

Me këtë ligj rregullohen kërkesat për mbrojtjen e mjedisit jetësor, të cilat duhet t'i plotësojë paketimi gjatë prodhimit të tij, lëshimi në treg dhe veprimi ndaj mbeturinave nga paketimi që i përfshin detyrimet e operatorëve ekonomikë dhe të subjekteve tjera të cilët marrin pjesë në procesin e prodhimit, dhe lëshimit në treg të paketimit, kërkesat për grumbullimin, ripërdorimin, ripërpunimin, riciklimin dhe largimin, si dhe kushtet e tjera për veprim ndaj mbeturinave nga paketimi, njoftimi dhe instrumentet ekonomike për arritjen e qëllimeve nacionale për grumbullimin, përpunimin dhe riciklimin e mbeturinave nga paketimi.

**Neni 2**

**Zbatimi subsidiar i ligjeve të tjera**

(1) Për çështjet të cilat janë të lidhura me mënyrën e trajtimit të mbeturinave nga paketimet, të cilat nuk janë të rregulluara në mënyrë të veçantë me këtë ligj, në mënyrë përkatëse do të zbatohen dispozitat e Ligjit të Menaxhimit të Mbeturinave.

(2) Për rregullimin e çështjeve lidhur me: qasjen në informatat që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor dhe pjesëmarrjen e publikut në miratimin vendimeve, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e rregulloreve për mjedisin jetësor.

(3) për rregullimin e çështjeve në lidhje me organizimin e prodhuesve në sisteme kolektive për zbatimin e parimit përgjegjës së zgjeruar të prodhuesve për menaxhimin me paketimin dhe mbeturina nga paketimi, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e rregulloreve për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesve për menaxhim me rrjedhat e veçanta të mbeturinave.

(4) Në procedurat e përcaktuara me këtë ligj, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(5) Zbatimi i dispozitave të këtij ligji nuk e përjashtojnë zbatimin e rregulloreve për sigurin, shëndet, higjienë, mbrojtje sanitare si dhe rregulloret nga fusha e menaxhimit me mbeturina.

**Neni 3**

**Qëllimi i ligjit**

(1) Qëllimet kryesore të këtij ligji janë:

- zvogëlimi i ndikimit negativ të paketimit dhe të mbeturinave nga paketimi në mjedisin jetësor dhe në shëndetin e njeriut dhe
- avancimi i standardeve për mbrojtjen e mjedisit jetësor nga operatorët ekonomikë gjatë ciklit jetësor të paketimit dhe posaçërisht gjatë trajtimit, ripërdorimit, përpunimit dhe largimit të mbeturinave nga paketimi.

\* Me këtë ligj Me këtë ligj bëhet harmonizimi me Direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit të 20 dhjetorit 1994 (94/62 / BE), mbi paketimin dhe hedhurinat e paketimit (CELEX Nr. 319494L0062), Direktivën 2004/12 / BE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të 11 shkurtit 2004 që ndryshon Direktivën 94/62 / BE mbi paketimin dhe mbetjet e paketimit (CELEX Nr. 32004L0012), Direktiva e Komisionit 2013/2 / BE e 7 Shkurt 2013, për ndryshimin e Aneksit I të Direktivës 94/62 / BE të Parlamenti Europian dhe të Këshillit për Paketimin dhe Mbetjet e Paketimit (CELEX Nr. 32013L0002), Direktiva (BE) 2015/720 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, e 29 Prill 2015, për ndryshimin e Direktivës 94/62/EC në lidhje me reduktimin e konsumit të qeseve plastike të holla për pazar (CELEX nr.32015L0720) dhe Direktivën (BE) 2018/852 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të 30 majit 2018 që ndryshon Direktivën 94/62/EC mbi paketimin dhe mbeturinat e paketimit (CELEX nr. 32018L0852)

(2) Përveç qëllimeve kryesore sipas paragrafit (1) të këtij neni, në pajtim me parimin sipas nenit 4 të këtij ligji, duhet të arrihen edhe qëllimet në vijim:

- të pengohet krijimi i mbeturinave nga paketimi,
- të zvogëlohet dhe të kufizohet përdorimi i metaleve dhe materieve të dëmshme dhe substancave tjera helmuese në paketim, dhe me këtë ta zvogëlojë ndikimin helmues të mbeturinës nga paketimi,
- të arrihet grumbullimi i veçantë i mbeturinës nga paketimi në vendin e krijimit të tyre;
- të arrihet nivel i lartë i ripërdorimit, riciklimit dhe llojeve tjera të përpunimit të mbeturinave nga paketimi dhe bashkë me të zvogëlimi i deponimit të mbeturinës nga paketimi;
- të sigurohen kushte të volitshme për vendosjen dhe zhvillimin e tregut për ripërdorim, riciklimin dhe mënyra tjera të përpunimit të mbeturinave nga paketimi;
- të sigurohet funksionimi i tregut pa pengesa në tregti dhe sigurimi i pozitës së barabartë e tregut të personave të vendit dhe të huaj juridikë dhe fizikë, dhe të shmangien barrierave tregtare të cilat mund ta prishin konkurrencën në treg;
- zvogëlimi i konsumit të energjisë dhe i përdorimit të lëndëve të para në prodhimin e paketimit dhe nxitjen e trajtimit të mbeturinave nga paketimi;
- të inkurajohet përdorimi i teknologjive më të mira të disponueshme për trajtimin, përpunimin dhe riciklimin e mbeturinave nga paketimi; dhe
- të inkurajohet prodhimi i paketimit të ripërdorshëm që është i biodegradueshëm.

#### **Neni 4 Parimet**

(1) Në pajtim me qëllimet për mbrojtje afatgjatë të mjedisit jetësor dhe arritjes së ekonomisë qarkulluese, menaxhimi i paketimit dhe i mbeturinave nga paketimi bazohet në:

1) "parimi i përgjegjësisë së prodhuesit", sipas së cilës prodhuesi i cili gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij krijon dhe kontribuon në krijimin e mbeturinave nga paketimi është përgjegjës për marrjen e masave për menaxhimin e paketimit dhe mbeturinave nga paketimi me qëllim eliminimin dhe / ose zvogëlimin e tyre deri në masë të mundshme ndikimin negativ në mjedisin jetësor që ndodh si rezultat i mbeturinave nga paketimi të krijuara nga aktiviteti i tij, duke përfshirë edhe krijimin e kushteve për realizimin e shkallës të lartë të grumbullimit të veçantë, ripërdorimit, riciklimit dhe mënyrës tjetër të përpunimit të mbeturinave të paketimit dhe

2) "parimi i vlerësimit të ciklit jetësor të prodhimit", sipas të cilit prodhuesi i paketimit është i detyruar të vlerësojë ciklin jetësor të paketimit në mënyrë me të cilën do të përmirësohen performancat ekologjike të paketimit, do të përjashtohet ose zvogëlohet prania e metaleve të dëmshëm dhe substancave tjera helmuese në paketimin në përputhje me arritjet shkencore-teknike, si dhe dizajnimin e paketimit në mënyrë që do të kontribuojë në zvogëlimin e vëllimit të përgjithshëm të mbeturinave të paketimit në mënyrë që të parandalohen ndikimet negative në mjedisin jetësor.

(2) Në menaxhimin e paketimit dhe mbeturinave nga paketimi, përveç parimeve të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni, në mënyrë të përshtatshme zbatohen edhe parimet e përcaktuara në rregulloret për mjedisin jetësor, rregulloret e menaxhimit të mbeturinave dhe rregulloret për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesit për menaxhimin e rrjedhave të veçantat e mbeturinave.

#### **Neni 5 Zbatimi i ligjit**

(1) Dispozitat e këtij ligji zbatohen në të gjitha llojet e paketimeve që lëshohen në treg në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për të gjitha mbeturinat nga paketimi, i cili krijohet në amvisëritë dhe nga kryerja e veprimtarisë industriale, tregtare, shitjes, shërbyese,

administrative dhe veprimtari tjetër në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, pa marrë parasysh llojin e materialit të paketimit dhe të mbeturinave nga paketimi.

(2) Dispozitat e këtij ligji nuk e përjashtojnë zbatimin e dispozitave të cilat i rregullojnë kërkesat për cilësinë e paketimit, siç janë ato për sigurinë, mbrojtjen e shëndetit, higjienën dhe mbrojtjen sanitare të prodhimeve të paketuara, si dhe dispozitat që janë të lidhura me transportin e prodhimeve dhe kontrollin veprimin ndaj hedhurinave dhe hedhurinave nga paketimet.

(3) Masat, standardet dhe qëllimet të cilat janë të përcaktuara me këtë ligj, zbatohen si kërkesa minimale të cilat duhen të plotësohen gjatë menaxhimit të paketimit dhe të mbeturinave.

(4) Nëse me ligj tjetër janë përcaktuar masa dhe standarde më të rrepta për mbrojtjen e mjedisit jetësor, gjatë menaxhimit të paketimit dhe të mbeturinave, zbatohen masa më të rrepta dhe standarde me qëllim të arrijtes së qëllimeve për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

## **Neni 6** **Definicione**

(1) Shprehje të veçanta të përdorura në këtë ligj, e kanë kuptimin siç vijon:

1) "**Paketim**", janë të gjitha prodhimet e bëra nga cilido lloj material i çdo natyre që shfrytëzohen për ruajtjen, mbrojtjen, trajtimin, dërgimin dhe prezantimin e mallrave, nga prodhuesi të shfrytëzuesi ose konsumuesi, pa marrë parasysh atë se a janë mallrat lëndë e parë ose prodhim i gatshëm. Sendet "e pakthyeshme" që shfrytëzohen për qëllimet e njëjta, gjithashtu do të llogariten si paketim. Paketimi mund të jetë:

a) paketimi për shitje ose primar (në tekstin në vijim: paketimi për shitje), është paketim i bërë në atë mënyrë që paraqet njësi të vetme për shfrytëzuesin ose konsumuesin e fundit në vendin e shitjes.

b) paketim grupor ose sekondar (në tekstin në vijim: paketimi grupor) është paketimi i bërë në atë mënyrë që si grup, i mbështjell ose mban së bashku një numër më të madh të njësive themelore shitëse me paketim shitës të llojit të njëjtë ose të ndryshëm të mallit në vendin e blerjes, pa marrë parasysh se a i shiten shfrytëzuesit ose konsumuesit të fundit si grup, ose shiten veç e veç sipas njësisë shitëse ose përdoren si mjet për dërgim deri në vendin e shitjes. Paketimi grupor mund të mënjanohet nga njësitë shitëse pa ndikuar në karakteristikat e tij;

v) paketimi për transport ose terciar (në tekstin në vijim: paketimi për transport) është paketim i bërë në mënyrë, i cili lehtëson trajtimin dhe transportin në njësitë e shitjes ose paketimi grupor për të parandaluar dëmtimin fizik gjatë trajtimit dhe transportit. Kontejnerët, të cilët janë për transportin e mallrave përdoren në komunikacionin rrugor, hekurudhor, detar ose ajror, nuk janë paketim transporti.

2) "**Mbeturinat nga paketimi**" është çdo paketim ose material për paketim i cili përfshihet me përkufizimi për mbeturina në Ligjin e Menaxhimit të Mbeturinave, me përjashtim të mbetjeve të krijuara gjatë prodhimit të paketimit;

3) "**Paketimi i ripërdorueshëm**" është paketimi i menduar mirë, dizajnuar dhe lëshuar në treg në mënyrë të tillë që gjatë ciklit të tij jetësor të ripërdoret një herë ose më shumë herë dhe / ose një ose më shumë herë mund të rimbushet për të njëjtin qëllim për të cilin ishte fillimisht i bërë;

4) "**Paketimi kompozit**" është paketimi i përbërë nga një ose më shumë shtresa të materialeve të ndryshme që nuk mund të ndahen me dorë dhe që paraqesin tërësi të vetme integrale e përbërë nga enë e brendshme e veshur me mbulesë të jashtme e cila si e tërë mbushet, ruhet, transportohet dhe zbrazet;

5) "**Plastika**" është material sintetik i përpunuar nga spektër i gjerë i polimerive organike si polietileni, PVC, qese dhe të tjera, të cilat mund të formohen në formë të caktuar përderisa është e butë dhe më pas të vendosen në formë të fortë ose pak elastike;

6) "**Qeset plastike për bartjen e mallrave**" janë qeset për bartje, me ose pa doreza, të bëra prej plastike, të cilat janë në dispozicion të konsumatorëve në vendet e shitjes së mallrave dhe prodhimeve;

7) "**Qeste plastike të lehta për bartje të mallrave**" janë qeset plastike për bartje, trashësia e të cilave është më pak se 50 mikronë;

8) "**Qeset plastike shumë të lehta për bartjen e mallrave**" janë qese plastike për bartje, trashësi e të cilave është më e vogël se 15 mikronë, të cilat janë të nevojshme për qëllime higjienike ose jepen si paketim parësor për ushqimin që nuk është kompakt ose është në gjendje të lëngët kur ajo ndihmon për parandalimin e hedhjes së ushqimit;

9) "**Qeset plastike oksodegraduese**" janë qeset plastike bartëse të bëra nga materiale plastike që përfshijnë aditivë që përshpejtojnë prishjen e materialeve plastike në mikropjesë;

10) "**Operatorët ekonomikë**" të lidhur me paketimin janë:

a) "furnizuesi i materialeve të paketimit" i cili është person juridik ose fizik, i cili prodhon ose vendos në qarkullimin e lirë paketimet dhe konvertuesit e tyre, si veprimtari e tij,

b) "prodhuesi" i cili është person juridik ose fizik i cili paketon mallra ose mbush mallra në paketime, si prodhon ose vendos në qarkullim të lirë mallra të paketuara në paketime, si veprimtari e tij, duke përfshirë edhe prodhuesin i cili si shfrytëzues i fundit lëshon në qarkullim të lirë mallra të paketuara.

v) "prodhues i vogël" i cili është person juridik ose fizik që paketon mallra ose mbush mallra në paketime, si dhe prodhon ose vendos në qarkullim të lirë mallra të paketuara në paketime si veprimtari e tij, duke përfshirë edhe prodhuesin i cili si shfrytëzues i fundit vendos mallra të paketuara në qarkullim të lirë në sasi të barabarta ose më të vogla se ato të përshkruara në nenin 26, paragrafi (1) të këtij ligji;

g) "tregtari" i cili është person juridik ose fizik, i cili në zinxhirin e furnizimit, e bën produktin në dispozicion të shfrytëzuesit përfundimtar.

11) "**Shfrytëzuesi përfundimtar**" është konsumator i cili për shkaqe të përdorimit përfundimtar ose konsumimit të produktit të pakeluar, ndan produktin dhe/ose e zbrazë nga paketime dhe në atë mënyrë krijon mbeturina prej tyre.

12) "**Kthim i paketimeve**", është aktivitet me të cilin sigurohet pranimi kthyes i mbeturinave nga paketime, i cili nuk e rrezikon shëndetin e njerëzve dhe nuk zbaton procese ose metoda të cilat do të ishin të dëmshme për mjedisin jetësor;

13) "**Futja e qëllimshme**", është aktivitet me të cilin me qëllim shfrytëzohet substanca ose materia gjatë prodhimit të paketimit ose të komponentëve të paketimit, me çka prania e saj e përhershme në paketimin e fundit ose në komponentin e paketimit, është e nevojshme që të arrihen karakteristika specifike, pamje ose kualitet i paketimit. Përdorimi i materialeve të ricikluara si lëndë të para për prodhimin e materialeve të reja për paketim, ku një pjesë e materialeve të ricikluara mund të përmbajnë sasi të substancave dhe materieve të rregulluara, nuk llogaritet për futje e qëllimshme;

14) "**Prani e rastësishme**", është prania e metalit si përbërje e futur pa qëllim në paketim ose pjesë të paketimit.

15) "**Organ i Mjedisit Jetësor**" përgjegjës për punët e mjedisit jetësor, përkatësisht Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor;

16) "**Organ profesional**" është Drejtoria e Mjedisit Jetësor, organ në përbërje të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe të Planifikimit Hapësinor dhe

17) "**Marrëveshja vullnetare**", është marrëveshja formale e cila ka klauzola ekzekutive, e lidhur ndërmjet organizatave të cilat i përfaqësojnë interesat e caktuara të operatorëve ekonomikë, dhe grupeve të operatorëve ekonomikë të përfshirë me këtë ligj nga njëra anë dhe organi për mjedisin jetësor ose Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga ana tjetër, me qëllim që të arrihen qëllimet e këtij ligji i cili është i hapur për qasjen e të gjithë personave juridikë dhe fizikë, të cilët duan t'i plotësojnë kushtet e përcaktuara me marrëveshje.

(2) Për nevojat e këtij ligji, do të zbatohen në mënyrë të përshtatshme përkufizimet nga Ligji i Menaxhimit të Mbeturinave, të cilat kanë të bëjnë me mbeturinat, menaxhimin e hedhurinave, mbledhjen, grumbullimin, parandalimin, ripërdorimin, përpunimin, rigjenerimin, riciklimin, asgjësimin dhe importin e mbeturinave.

(3) Për nevojat e këtij ligji, do të zbatohen në mënyrë të përshtatshme përkufizimet nga Ligji për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesit në menaxhimin me rrjedhat speciale të hedhurinave, të cilat i referohen shprehjeve përgjegjësi e zgjeruar e prodhuesit dhe veprim kolektiv.

## **Neni 7**

### **Kriteret për përcaktimin e paketimit**

(1) Për përcaktimin e lëndës që paraqet paketim, përdoren edhe këto kriteret:

1) lënda do të konsiderohet paketim nëse i plotëson kërkesat e nenit 6, paragrafi (1), pika 1) të këtij ligji, pavarësisht nga funksionet e tjera që mund të ketë, me kusht që paketimi të jetë pjesë integrale e prodhimit dhe të jetë i domosdoshëm për ruajtjen e përmbajtjes së tij, mbështet ose mbron prodhimin gjatë gjithë ciklit të tij jetësor dhe të gjithë elementet e paketimit janë të dedikuara që të përdoren, konsumohen dhe mënjahohen bashkë me produktin;

2) lënda që është e dizajnuar ose dedikuar që të mbushet me përmbajtje në pikën e shitjes dhe lënda e dedikuar "për përdorim të njëhershëm që shitet, mbushet ose është e dizajnuar dhe dedikuar të mbushet në pikën e shitjes, do të llogaritet për paketim me kusht që ta plotësojë funksionin e paketimit dhe

3) pjesët përbërëse të paketimit dhe elementet tjera ndihmëse të vendosura në paketim, llogariten për pjesë të paketimit në të cilën janë të vendosura. Elementet ndihmëse që janë varur në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose të vendosura në një prodhim dhe që kryejnë funksionin e paketimit, llogariten si paketime, përveç nëse nuk janë pjesë përbërëse e atij prodhimi dhe nëse të gjitha elementet janë të dedikuara të shfrytëzohen ose mënjahohen, së bashku me prodhimin.

(2) Ministri që udhëheq organin e mjedisit jetësor shpall listë të shembujve ilustrues të paketimit në përputhje me kriteret sipas paragrafit (1) të këtij neni, në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

## **Neni 8**

### **Lëshimi në treg i paketimit**

(1) Paketimi mund të lëshohet në treg në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nëse i plotëson kërkesat e përcaktuara me këtë ligj, që kanë të bëjnë me prodhimin, përbërjen e paketimit, natyrën e paketimit që përsëri mund të përdoret dhe përpunohet, përshtatshmërinë e paketimit për përpunim dhe riciklim, nivelin e përqendrimit të metaleve të rënda, kërkesat e përcaktuara në standardet dhe kërkesat për identifikimin dhe shënimin e paketimit.

(2) Lëshimi i paketimit në treg është furnizim ose vënie në dispozicion, nëpërmjet prodhimit ose importit të produktit të paketuar, të destinuar për konsum ose përdorim për herë të parë në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Me përjashtim sipas paragrafit (2) të këtij neni, qeset për bartjen e mallrave konsiderohen se janë të lëshuara në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut kur ato i shiten shfrytëzuesit përfundimtar.

## **Neni 9**

### **Masat parandaluese**

Për të parandaluar krijimin e mbeturinave nga paketimi dhe për të minimizuar efektet e dëmshme mbi mjedisin jetësor nga mbeturinat e paketimit, në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e rregullave të menaxhimit të mbeturinave.

## **Neni 10**

### **Lëshimi në treg i qeseve për bartjen e mallrave dhe paketimit plastik për një përdorim**

- (1) Ndalohet lëshimi në treg i qeseve të plastikës për bartjen e mallrave në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- (2) Ndalohet lëshimi i paketimit plastik për një përdorim në objektet hotelierike në territorin e zonave të mbrojtura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- (3) Përjashtim sipas paragrafit (1) të këtij neni, me pagesën e kompensimit nga ana e shfrytëzuesve përfundimtarë, lejohet lëshimi në treg i qeseve biodegraduese në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të prodhuara në pajtim me standardet e përcaktuara për biodegradim, përveç qeseve plastike shumë të lehta për bartjen e mallrave.
- (4) Kompensimin që duhet ta paguajnë shfrytëzuesit përfundimtarë sipas paragrafit (3) të këtij neni për qeset biodegraduese për bartjen e mallrave është 15 denarë për copë dhe i paguhet tregtarit në pikën e shitjes.
- (5) Tregtari sipas paragrafit (4) të këtij neni është i detyruar të mbajë evidencë në bazë tremujore për numrin e qeseve të shitura në pikën e shitjes që ia dorëzon organit kompetent dhe shumën e përgjithshme të marrë nga qeset e shitura në bazë tremujore ia transferon në llogari të veçantë, të hapur për atë qëllim organit të mjedisit jetësor.
- (6) Ministri i cili udhëheq organin e mjedisit jetësor dhe të planifikimit hapësinor i përcakton standardet për biodegradimin sipas paragrafit (3) të këtij neni që duhet t'i plotësojnë qeset për bartjen të mallrave, mënyrën e lëshimit në treg të qeseve biodegraduese nga ana e tregtarëve si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit për mbajtjen e evidencës sipas paragrafit (5) të këtij neni.
- (7) Organi profesional, në bazë të evidencës sipas paragrafit (5) të këtij neni, më së voni deri më 31 janar të vitit aktual, përcakton sasinë vjetore të qeseve plastike të përdorura në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin e kaluar, në bazë të metodologjisë së përcaktuar në nenin 13 të Ligjit të Përgjegjësisë së Zgjeruar të prodhuesit për menaxhimin e rrjedhave të veçanta të mbeturinave.

## **II. KËRKESA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT JETËSOR**

### **Neni 11**

#### **Kërkesat në pikëpamje të prodhimit dhe përbërjes së paketimit**

- (1) Paketimi duhet të përpunohet në mënyrë të tillë që vëllimi dhe pesha e paketimit të jenë të kufizuara në sasinë minimale përkatëse për të ruajtur nivelin e kërkuar të sigurisë, higjienës dhe pranueshmërisë për produktin e paketuar dhe për konsumatorin.
- (2) Paketimi duhet të jetë i dizajnuar, prodhuar dhe i shitur në mënyrë që do të mundësojë ripërdorimin ose përpunimin, duke përfshirë edhe riciklimin, në përputhje me hierarkinë për menaxhim të mbeturinave, çka ndikimi negativ në mjedisin jetësor reduktohet në minimum, gjatë mënjanimit të mbeturinave nga paketimi ose të mbeturinave të tij, të krijuara gjatë ndërmarrjes së operacioneve për veprim ndaj mbeturinave e paketimit.
- (3) Paketimi duhet të jetë i përpunuar në mënyrë që prania e materieve të dëmshme dhe substancave të tjera të rrezikshme si përbërës të materialit për paketim ose të cilit do komponent të paketimit, lidhur me praninë e tyre në imitimet, hirin dhe në ekstraktin e lëngët që krijohet gjatë djegies ose nga deponimi i mbeturinave nga paketimi ose mbeturinave të krijuara gjatë ndërmarrjes së operacioneve për veprim me mbeturinat e paketimit, do të reduktohen në minimum.

## **Neni 12**

### **Kërkesa në aspektin e natyrës së paketimeve të cilat janë të dedikuara për ripërdorim**

Paketimet të cilat janë prodhuar me qëllim që të ripërdoren, duhet t'i përmbushim këto kërkesa:

- 1) cilësitë fizike dhe karakteristikat e paketimit duhet të jenë të atilla që do të sigurojnë kualitet adekuat të paketimit, me qëllim të ripërdorimit të tij në kushte normale të parapara të shfrytëzimit,
- 2) të mundësojnë që gjatë përpunimit të paketimit të shfrytëzuar, të përmbushen kërkesat lidhur me kushtet shëndetësore dhe të sigurisë për mbrojtje gjatë punës dhe
- 3) t'i përmbushë kushtet specifike të kërkuara për përpunimin të paketimit, kur paketimi do të shndërrohet në mbeturinë dhe nuk do të përdoret përsëri.

## **Neni 13**

### **Kërkesa në pikëpamje të përshtatjes së paketimit për përpunim**

Paketimi në aspekt të përshtatjes së tij për përpunim të materialit, duhet t'i plotësojë kërkesat në vijim:

- 1) paketimi i cili mund të përpunohet nëpërmjet operacioneve të riciklimit përpunohet në mënyrë që kur do të shndërrohet në mbeturinë të paketimit do të mundë të riciklohet përqindje e caktuar e peshës së materialeve që janë shfrytëzuar në përpunimin e produktit, i cili është i dedikuar për shitje, në përputhje me standardet e vlefshme. Përcaktimi i kësaj përqindjeje mund të ndryshojë, varësisht nga lloji i materialit nga i cili përbëhet paketimi,
- 2) paketimi i cili mund të përpunohet nëpërmjet operacioneve të përpunimit energjetik, kur do të shndërrohet në mbeturinë nga paketimi, duhet të ketë vlerë minimale të kalorisë që të mundësohet prodhim optimal i energjisë,
- 3) paketimi i cili mund të përpunohet nëpërmjet operacioneve të kompostimit, duhet të përpunohet në mënyrë që kur do të shndërrohet në mbeturinë nga paketimi, të ketë cilësi biodegraduese që nuk do ta pengojë grumbullimin e veçantë dhe procesin e kompostimit ose aktivitetin në të cilin ajo përfshihet dhe
- 4) paketimi i cili është prodhuar nëpërmjet materieve biodegraduese, duhet të jetë i përpunuar në mënyrë që kur do të shndërrohet në mbeturinë nga paketimi, të jetë i asaj natyre që të mund t'i ekspozohet degradimit fizik, kimik, termik ose biologjik, kështu që pjesa më e madhe e kompostimit përfundimtar, në fund do të degradohet në dioksid karboni, biomasë dhe ujë. Në kuptim të kësaj pike, paketimi plastik okso-degradues nuk llogaritet biodegradues.

## **Neni 14**

### **Kërkesa në pikëpamje të niveleve të përqendrimit të metaleve të rënda të pranishme në paketim**

(1) Niveli i përgjithshëm i përqendrimit të plumbit, kadmiumit, zhivës dhe kromit gjashtëvalent (në tekstin e mëtejshëm: metale të rënda) të pranishëm në paketim dhe në materialin ose komponentët e tij përbërës, nuk guxon të tejkalojë 100 ppm nga masa e paketimit, përveç për paketimin i cili në tërësi është bërë nga qelqi i kristalizuar i plumbit.

(2) Prodhuesi ndaj dërgesës së paketimit që e lëshon në treg është i detyruar që të dorëzojë të dhëna se janë përmbushur kërkesat sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, përmbajtja e metaleve të rënda mund ta tejkalojë nivelin prej 100 ppm nga masa e paketimeve të qelqit, arka të plastikës dhe paletave të përpunuara nga materialet e ricikluara dhe përderisa metalet e rënda nuk janë futur qëllimisht në procesin prodhues, përkatësisht janë të pranishme rastësisht gjatë procesit të riciklimit.

(4) Subjektet sipas paragrafit (2) të këtij neni, si dhe ato subjektet paketime i të cilave përmban metale të rënda sipas paragrafit (3) të këtij neni, janë të detyruar që të mbajnë evidencë për nivelin e pranisë së metaleve të rënda në paketimet, dhe të dorëzojnë raport vjetor për veprim ndaj atyre paketimeve te organi profesional.

(5) Raporti vjetor sipas paragrafit (4) të këtij neni dorëzohet te organi profesional njëkohësisht me raportin vjetor sipas nenit 19 të këtij ligji.

(6) Ministri i cili udhëheq organin e mjedisit jetësor e përcakton mënyrën e kushteve për tejkalimin e niveleve të përmbajtjes së metaleve të rënda sipas paragrafit (3) të këtij neni, si dhe mënyrën e mbajtjes dhe përmbajtjen e evidencës dhe raportit sipas paragrafit (4) të këtij neni.

(7) Rezultatet e matjeve të kryera në proceset e prodhimit si dhe metodat matëse të shfrytëzuara, duhet të ruhen së paku katër vite dhe të njëjtat të jenë në dispozicion në çdo kohë për organet kompetente sipas nenit 40 të këtij ligji.

## **Neni 15**

### **Kërkesat në pikëpamje të zbatimit të standardeve gjatë menaxhimit të paketimit dhe të mbeturinave**

(1) Paketimi që prodhohet dhe lëshohet në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duhet të jetë në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane për prodhim të paketimit.

(2) Paketimi i plotëson kërkesat e përcaktuara në standardet sipas paragrafit (1) të këtij neni, nëse është prodhuar në përputhje me:

1) standardet e vendosura evropiane të pranuar si kombëtare, e që kanë të bëjnë me:

a) kriteret dhe metodologjinë për analizë të ciklit jetësor të paketimit;

b) metodat për matjen dhe verifikimin e pranisë së metaleve të rënda dhe substancave tjera të dëmshme në paketim dhe lëshimin e tyre në mjedisin jetësor nga paketimi dhe mbeturinat nga paketimi,

v) kriteret për përmbajtjen minimale të materialit që riciklohet për lloje përkatëse të paketimit;

g) kriteret për metodat e riciklimit;

d) kriteret për metodat e kompostimit dhe kriteret për kompostimin e krijuar;

gj) kriteret për shënimin e paketimit dhe

2) standardet e tjera kombëtare nga sfera e kualitetit të paketimit

## **Neni 16**

### **Kërkesa në pikëpamje të identifikimit dhe shënimit të paketimit**

(1) Paketimi identifikohet dhe shënohet në përputhje me natyrën e materialit nga i cili është prodhuar paketimi, me qëllim që të lehtësohet grumbullimi, ripërdorimi dhe përpunimi, duke e përfshirë edhe riciklimin e paketimit.

(2) Paketimi duhet të identifikohet dhe shënohet me shenjë adekuate në vetë paketimin ose në etiketën e tij.

(3) Shënimi duhet t'i përmbajë të dhënat siç vijojnë:

1) llojin e materialit të përdorur në paketim;

2) mundësinë e ripërdorimit nëse ekziston; dhe

3) mundësinë e përpunimit, përkatësisht të riciklimit nëse ekziston.

(4) Shenja duhet të jetë qartë e dukshme dhe lehtë e lexueshme, gjatë shitjes dhe gjatë kthimit të paketimit, e qëndrueshme dhe e përhershme, madje edhe kur paketimi është i hapur.

(5) Ministri i Mjedisit Jetësor dhe i Planifikimit Hapësinor, në përputhje me ministrin e Ekonomisë, do t'i përcaktojë mënyrën e numërimit dhe shkurtesave në të cilat bazohet sistemi i identifikimit dhe shënimit të materialeve nga të cilat është prodhuar paketimi, si dhe formën dhe përmbajtjen e shënimit për veprim ndaj paketimit.

### **III. OBLIGIMET E PRODHUESVE**

#### **Neni 17 Regjistrimi**

Prodhuesit ose shfrytëzuesit përfundimtarë të cilët lëshojnë mallra të paketuara në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut në përputhje me nenin 8 të këtij ligji, janë të detyruar të regjistrohen te organi profesional, në përputhje me mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me rregulloren për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesit për menaxhimin e rrjedhave të veçanta të mbeturinave.

#### **Neni 18 Prodhuesit e regjistruar jashtë vendit**

(1) Prodhuesi i cili nuk është i regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut i cili lëshon mallra të paketuara në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet komunikimit në distancë (tregti elektronike), përmbush detyrimet që dalin nga ky ligj duke caktuar përfaqësues të autorizuar në përputhje me mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me rregulloren për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesit për menaxhimin e rrjedhave të veçanta të mbeturinave.

(2) Nëpërmjet përcaktimit të përfaqësuesit të autorizuar, detyrimet që rrjedhin nga ky ligj për prodhuesin sipas paragrafit (1) të këtij neni, për paketimin e lëshuar në treg në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të barten plotësisht te përfaqësuesi i autorizuar.

#### **Neni 19 Mbajtja e evidencës dhe njoftimi**

(1) Prodhuesi është i detyruar të mbajë shënime për llojin dhe sasinë e paketimeve të lëshuara për herë të parë në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas llojit të materialit nga i cili prodhohet paketimi, gjatë një viti kalendarik me shkrim dhe formë elektronike.

(2) Prodhuesi është i detyruar t'i dorëzojë raport vjetor organit profesional më së voni deri më 31 mars të vitit aktual për llojin dhe sasinë e paketimit që ka lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin e kaluar kalendarik në formular për raportin vjetor të paketimit dhe mbeturinave nga paketimi, në formë të shkruar dhe elektronike. Në raportin vjetor bashkëngjitet edhe shënohet dëshmia për praninë e metaleve të rënda sipas nenit 14 të këtij ligji.

(3) Prodhuesi është i detyruar që për secilin produkt të përgatisë specifikim të prodhimit i cili përmban informacion në lidhje me peshën e paketimit të atij produkti, përfshirë edhe paketimet grupore dhe transportuese.

(4) Prodhuesi është i detyruar që në bazë të specifikimit të prodhimit sipas paragrafit (3) të këtij neni të mbajë evidencë mujore dhe vjetore për paketimin e përgjithshëm të cilin e ka lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(5) Prodhuesi është i detyruar të mbajë evidencë për sasinë e mbeturinave nga paketimi që është kthyer mbrapa, sipas kategorisë, në një vit të caktuar si dhe për dëshminë për mbeturinat nga paketimi të dorëzuar tek grumbulluesit ose ricikluesit, në përputhje me rregulloret për menaxhimin e mbeturinave .

(6) Forma dhe përmbajtja e formularit të raportit vjetor sipas paragrafit (2) të këtij neni, forma dhe përmbajtja e formës së specifikimit të prodhimit sipas paragrafit (3) të këtij neni, forma

dhe përmbajtja e formularit për evidencë sipas paragrafit (4) të këtij neni përcaktohen nga ministri i cili udhëheq organin e mjedisit jetësor.

(7) Të dhënat nga regjistrat sipas paragrafit (1) të këtij neni ruhen pesë vjet llogaritur nga fundi i vitit kalendarik të cilit i referohen.

(8) Prodhuesi, i cili ka lidhur marrëveshje me veprues kolektiv në përputhje me rregulloret për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesit për menaxhimin e rrjedhave të veçanta të mbeturinave, detyrimin për të dorëzuar raport vjetor sipas paragrafit (2) të këtij neni e realizon nëpërmjet vepruesit kolektiv.

(9) Prodhuesi sipas paragrafit (8) të këtij neni është i detyruar të dorëzojë raport tremujor tek vepruesi kolektiv më së vonë deri ditën e 15-të të tremujorit aktual për tremujorin paraprak.

## **Neni 20**

### **Kthimi mbrapa i paketimit shitës, grupor dhe transportues**

(1) Prodhuesi është i detyruar që mbeturinat nga paketimi grupor dhe transportues, drejtpërdrejt pas dorëzimit të mallit ose gjatë dorëzimit të ardhshëm, ta pranojë prapa pa pagesë nëse shfrytëzuesi i fundit dëshiron ta kthejë. Nëse shfrytëzuesi i fundit e merr mallin vetë nga prodhuesi i paketimit, mbeturinën e paketimit grupor dhe transportues mund ta lë drejtpërdrejt në vendin e marrjes, ose ta kthejë gjithashtu pa pagesë.

(2) Obligimet sipas paragrafit (1) të këtij neni, zbatohen edhe për paketimin shitës i cili njëkohësisht e kryen funksionin e paketimit grupor ose transportues.

(3) Prodhuesi i paketimit është i detyruar që pa pagesë ta pranojë prapa mbeturinat nga paketimi shitës që janë mbeturina komerciale dhe/ose nuk janë mbeturina komunale, kur shfrytëzuesi i fundit dëshiron ta kthejë dhe për mbeturinat e atilla nuk janë përcaktuar mënyra të veçanta të veprimit.

(4) Për zbatimin e obligimeve sipas paragrafëve (1), (2) dhe (3) të këtij neni, prodhuesi i paketimit, është i obliguar që të rregullojë hapësirë të caktuar dhe të sigurojë pajisje për grumbullimin përzgjedhës të mbeturinave nga paketimi, nëse ka hapësirë shitëse më të madhe se 200 m<sup>2</sup>.

(5) Prodhuesi, sasi të e grumbulluara të mbeturinave nga paketimi mund t'i magazinojë për kohësisht ndaras, në hapësirën e vet të mbyllur ose të hapur.

(6) Prodhuesi që ka hapësirë më të vogël shitëse se 200 m<sup>2</sup>, mund të rregullojë hapësirë dhe të sigurojë pajisje për grumbullimin përzgjedhës të mbeturinave nga paketimi.

(7) Prodhuesi nuk duhet të ketë leje për menaxhimin e mbeturinave nga paketimi, në përputhje me rregulloren për menaxhimin e mbeturinave, për hapësirat e tij për kthimin e mbeturinave nga paketimi.

## **Neni 21**

### **Obligim i prodhuesit për grumbullimin, përpunimin dhe riciklimin e mbeturinave nga paketimi**

(1) Prodhuesi është i detyruar të sigurojë realizimin e qëllimeve kombëtare nga ky nen që kanë të bëjnë me grumbullimin, riciklimin dhe përpunimin e mbeturinave nga paketimi, të krijuara nga produktet e paketuara të lëshuara në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(2) Sasia e mbeturinave nga paketimi që secili prodhues është i detyruar të grumbullojë, përpunojë dhe riciklojë në vitin aktual është e barabartë me pjesën e tyre të paketimit nga sasia të përgjithshme e paketimit të lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin paraprak sipas kategorisë së produkteve.

(3) Sasia e përgjithshme e paketimeve të lëshuara në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut për përcaktimin e sasisë minimale për grumbullim, përpunim dhe riciklim përcaktohet nga organi kompetent në përputhje me rregulloren për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesve për menaxhimin e rrjedhave të veçanta të mbeturinave.

(4) Qëllimet kombëtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut për grumbullimin, përpunimin dhe riciklimin e mbeturinave nga paketimi janë:

1) për paketimin që është i lëshuar në treg të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duhet të grumbullohen sasi të mëposhtme edhe atë:

- 55% për vitin 2021;
- 57% për vitin 2022;
- 60% për vitin 2023;
- 65% për vitin 2024;
- 70% për vitin 2025;
- 75% për vitin 2026;
- 80% për vitin 2027;
- 85% për vitin 2028.

2) deri në fund të vitit 2021, minimum 60% nga pesha e mbeturinave nga paketimi, të cilat janë krijuar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duhet të përpunohen me operacione për rigjenerim apo me operacione të përpunimit energjetik;

3) deri në fund të vitit 2021, minimum 55% e maksimum 80% nga pesha e mbeturinave nga paketimi, që është krijuar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duhet të riciklohet;

4) deri në fund të vitit 2021, sasi të vijuese të materialit nga të cilat prodhohet paketimi duhet të riciklohen:

- 40% e peshës së qelqit;
- 70% e peshës së letrës dhe kartonit;
- 50% e peshës së metaleve të hekurta;
- 10% e peshës së metaleve me ngjyra;
- 25% në krahasim me peshën e plastikës, ku merret parasysh vetëm materiali që është i ricikluar mbrapa në plastikë;
- 20% në krahasim me peshën e drurit;

5) më së voni deri më 31 dhjetor të vitit 2030, të paktën 65% e peshës së të gjitha mbeturinave nga paketimi do të riciklohen,

6) më së voni më 31 dhjetor të vitit 2030, duhet të përmbushen pikat e mëposhtme të peshës minimale për riciklim, në lidhje me materialet e posaçme që përmbahen në mbeturinat nga paketimi edhe atë:

- 50% plastikë;
- 25% dru;
- 70% metale hekuri;
- 50% alumin;
- 70% qelq;
- 75% letër dhe karton,

7) më së voni deri më 31 dhjetor 2035, të paktën 70% e peshës së të gjitha hedhurinave të paketimit do të riciklohen dhe

8) më së voni deri më 31 dhjetor 2035, duhet të përmbushen këto qëllime minimale sipas peshës për riciklim në lidhje me materialet e posaçme që përmbahen në mbeturinat e paketimit siç vijon:

- 55% plastikë;
- 30% dru;
- 80% metale hekuri;
- 60% alumini;
- 75% qelq dhe
- 85% letër dhe karton.

(5) Me qëllim të arritjes graduale të qëllimeve sipas paragrafit (4), pikat 5), 6), 7) dhe 8) të këtij neni, ministri që udhëheq organin e mjedisit jetësor vendos qëllime vjetore kombëtare për

grumbullimin, përpunimin dhe riciklimin e mbeturinave nga paketimi në përputhje me dokumentet e planifikimit të miratuar në përputhje me rregulloret për menaxhimin e mbeturinave, më së voni deri më 15 dhjetor në vitin aktual për vitin pasardhës.

(6) Prodhuesi është i detyruar të përcaktojë qëllimet e tij vjetore për grumbullimin, përpunimin dhe riciklimin e mbeturinave nga paketimi sipas kategorisë së mbeturinave në kilogram për vitin aktual, bazuar në pjesën e tyre të paketimit të lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin paraprak.

(7) Për nevojat e arritjes së qëllimeve të përmendura në paragrafin (4) pikat 5), 6), 7) dhe 8) të këtij neni, prodhuesi mund të caktojë qëllime të përshtatshme për vitin e dhënë, nëse tre vitet e fundit kanë vendosur në treg për herë të parë paketim të ripërdorshëm që është ripërdorur si pjesë e sistemit të ripërdorimit.

(8) Qëllimet e përshtatshme sipas paragrafit (7) të këtij neni llogariten duke marrë parasysh pjesën mesatare në tre vitet e fundit të paketimit të shitjeve të ripërdorshme të vendosura në treg për herë të parë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe cili është ripoëdorur si pjesë e sistemit për ripërdorimin e paketimit (në tekstin në vijim: pjesa mesatare).

(9) Prodhuesi, qëllimet e përshtatura sipas paragrafit (7) të këtij neni do t'i llogarisë me heqjen e:

a) pjesës mesatare, nga qëllimet e përcaktuara në paragrafin (4) pikat 5) dhe 7) të këtij neni, dhe

b) pjesës mesatare të përbërë nga materiali përkatës i paketimit, për qëllime të përcaktuara në paragrafin (4) pikat 6) dhe 8) të këtij neni.

(10) Qëllimet sipas paragrafit (4) pikat 5), 6), 7) dhe 8) të këtij neni mund të përshtaten deri në më së shumti 5% të qëllimit përkatës.

(11) Mënyra e llogaritjes së qëllimeve për grumbullimin, përpunimin dhe riciklimin e mbeturinave të paketimit të përmendura në paragrafin (4) të këtij neni, si dhe mënyra e llogaritjes së qëllimeve të përshtaturasipas paragrafit (8) të këtij neni, lajmërimi i të dhënave dhe mbajtja e evidencës i përcakton ministri i cili udhëheq organin për mjedisin jetësor.

(12) Organi për mjedisin jetësor mund të rishikojë qëllimet sipas paragrafit (4) pikat 5), 6), 7) dhe 8) të këtij neni mund ti rishikojë në përputhje me gjendjet e tregut, në përputhje me dokumentet e planifikimit të miratuar në përputhje me rregulloret për menaxhim të mbeturinave.

## **Neni 22**

### **Detyrimi për financimin e prodhuesit**

(1) Për paketimin që ka lëshuar në treg në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, prodhuesi është i detyruar të sigurojë financimin e shpenzimeve për aktivitetet e mëposhtme:

- pranim të kthimit të mbeturinave të paketimit në përputhje me nenin 20 të këtij ligji,
- grumbullim i veçmas, rruajtja e përkohshme e mbeturinave të paketimit, të paktën për sasinë që i përgjigjet pjesës përkatëse në arritjen e qëllimeve minimale kombëtare të grumbullimit sipas nenit 21 të këtij ligji;

- transportin, trajtimin, përpunimin, ripërdorimin, gjegjësisht riciklimin dhe largimin e pjesës tjetër të përpunimit të paketimit të mbeturinave, të paktën për sasinë që i përgjigjet pjesës përkatëse në arritjen e qëllimeve minimale kombëtar të trajtimit sipas nenit 21 të këtij ligji,

- shpenzimet e komunikimit me publikun, duke përfshirë shpenzimet në lidhje me paraqitjen e informacioneve për shfrytëzuesit e fundit, si në nenin 24 të këtij ligji,

- shpenzimet në lidhje me garancinë financiare,
- shpenzimet për investime në infrastrukturën e grumbullimit të mbeturinave që rezultojnë nga përdorimi i prodhimit për të siguruar selektimin e secilit lloj të veçantë të mbeturinave për të cilat prodhuesi ka detyrimet e menaxhimi,

- mbledhja e rregullt e mbeturinave të paketimit të mbledhura nga tregtari në përputhje me nenin 27 të këtij ligji,

- mbledhja e rregullt e mbeturinave të paketimit të krijuara nga amvisëritë, nga grumbulluesit e autorizuar, të cilat grumbullohen si fraksioni veçantë e mbeturinave të mbledhura komunale, si dhe,

- përmbushjen e detyrimeve të tjera të përcaktuara për prodhuesin në dispozitat e këtij ligji.

(2) Për përmbushjen e detyrimeve sipas paragrafit (1) të këtij neni, prodhuesi e vegjël sipas nenit 26 të këtij ligji do të paguajnë kompensim paushall në shumë prej 6,000 denarë në nivel vjetor në llogari të veçantë të buxhetit të organit të mjedisit jetësor dhe do të paguhet me rastin e regjistrimit si prodhues i vogël për vitin aktual.

(3) Kompensimin e parë sipas paragrafit (2) të këtij neni prodhuesi i vogël e paguan nga pas regjistrimit në pajtim me nenin 17 të këtij ligji.

(4) Shpenzimet për trajtimin e mbeturinave të paketimit sipas paragrafit (1) të këtij neni, prodhuesi nuk mund t'i paraqesë veçmas gjatë shitjes së mallrave të paketuara, përveç pagesës së qeseve biodegraduese për bartjen e mallrave sipas nenit 10 të këtij ligji dhe dorëzania në përputhje me nenin 33 të këtij ligji.

### **Neni 23**

#### **Garancia financiare**

(1) Prodhuesi është i detyruar të sigurojë një garanci financiare për zbatimin e detyrimeve të tij që dalin nga ky ligj, të cilat kanë të bëjnë me grumbullimin, trajtimin dhe përpunimin, si dhe riciklimin e mbeturinave të paketimit.

(2) Garancia financiare duhet të sigurohet për secilin vit kalendarik, në përputhje me rregulloret për përgjegjësinë e zgjëruar të prodhuesit për menaxhimin e rrjedhave të veçanta të mbeturinave.

### **Neni 24**

#### **Informacionet për shfrytëzuesit e paketimit**

(1) Prodhuesi është i detyruar të informojë në mënyrë përkatëse tregtarin dhe shfrytëzuesin e fundit për vetitë thelbësore të prodhimit dhe paketimit të tij në lidhje me materiet dhe substancat e rrezikshme dhe të dëmshme që ato përmbajnë dhe për mënyrën e veprimit të paketimit, kur bëhet mbeturinë nga paketimi.

(2) Prodhuesi është i detyruar për secilin lloj të materialit nga i cili prodhohet paketimi, i cili vendos në treg të ketë të dhëna për sasinë e metaleve të rënda sipas nenit 14 të këtij ligji.

(3) Prodhuesi është i detyruar të organizojë fushata për informimin e shfrytëzuesve të fundit dhe ngritjen e vetëdijes publike për:

- sistemet e vendosura për kthimin, grumbullimin dhe përpunimin e mbeturinave të paketimit,

- rolin dhe kontributin e tyre në ripërdorimin, përpunimin dhe riciklimin e paketimit dhe mbeturinave të paketimit,

- kuptimin e etiketave dhe shenjave në paketimin që janë në treg, dhe

- informacionin dhe të dhënat të përfshira në dokumentet e planifikimit të miratuara në përputhje me rregulloret për menaxhimin e mbeturinave, të cilat i referohen menaxhimit të paketimit dhe mbeturinave të paketimit.

(4) Prodhuesit e qeseve plastike për bartjen e mallrave duhet të informojnë shfrytëzuesit e fundit për të rritur vetëdijen për pasojat negative në mjedisin jetësor nga konsumi i tepërt i qeseve plastike për bartjen e mallrave.

## **Neni 25**

### **Pranimi i detyrimeve të prodhuesit**

(1) Prodhuesi është i detyruar që me shpenzimet e tij të sigurojë përmbushjen e detyrimeve dhe qëllimeve të këtij ligji, duke kthyer, grumbulluar, përpunuar dhe ricikluar mbeturinat e paketimit të krijuara nga lëshimi në treg të mallrave të paketuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(2) Prodhuesi është i detyruar të sigurojë:

- mbledhje dhe grumbullim të rregullt të paketimeve të përdorura dhe mbeturinave të paketimit nga shfrytëzuesi i fundit dhe amvisëritë në mënyrë që të përpunohen në sistemin e menaxhimit të mbeturinave të paketimit, dhe
- ripërdorimin, përpunimin, përfshirë riciklimin e mbeturinave nga paketimet të grumbulluara.

(3) Prodhuesi mund të përmbushë detyrimet sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni mund ti realizojë duke lidhur marrëveshje për marrjen e detyrimeve për trajtimin e mbeturinave të paketimit, me veprues kolektiv të mbeturinave të paketimit i cili është krijuar dhe posedon lejen në përputhje me rregulloret për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit për menaxhimin e rrjedhave të veçanta të mbeturinave.

## **Neni 26**

### **Detyrimet për prodhuesit e vegjël**

(1) Detyrimet sipas nenit 25 të këtij ligji nuk i referohen prodhuesit i cili çdo vit vendos në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut mallra të paketuara në sasi të barabarta ose më të vogla se:

- 800 kg qelq;
- 100 kg plastikë;
- 10 kg qese plastike;
- 300 kg letër, karton si dhe paketim me shumë shtresa të përbëra kryesisht nga pjesë kartoni;
- 100 kg metal ose
- 100 kg dru.

(2) Prodhuesi sipas paragrafit (1) të këtij neni është i detyruar të regjistrohet në pajtim me nenin 17 të këtij ligji, si dhe të mbajë evidencë dhe të dorëzojë raport në pajtim me nenin 19 të këtij ligji.

(3) Prodhuesi deri më 15 janar duhet të paraqesë kërkesë tek organi profesional për marrjen e aktvendimit për prodhues të vegjël, në të cilën theksohen edhe sasi të mallrave të paketuara që prodhuesi synon të lëshojë në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin aktual .

(4) Organi profesional me aktvendim përcakton nëse prodhuesi i plotëson kushtet për prodhues të vegjël për vitin aktual brenda 30 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës sipas paragrafit (3) të këtij neni.

(5) Organi profesional është i detyruar në regjistrin që mbahet në pajtim me rregulloret të zgjeruara të prodhuesit për menaxhim me rrjedhat e veçanta të mbeturinave, veçmas t'i mbajë prodhuesit dhe llojin e sasisë së paketimit për të cilën ka lëshuar aktvendim për prodhues të vogël.

(6) Prodhuesi sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk është i detyruar të sigurojë menaxhim të mbeturinave të paketimit nëse sasia e paketimit të lëshuar në treg nuk i kalon sasi të nivelin vjetor të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, por është i detyruar të paguajë kompensimin paushall vjetor sipas nenit 22 paragrafi (2) të këtij ligji.

## **IV. DETYRIMET E TREGTARIT**

### **Neni 27**

#### **Detyrimet për pranimin e kthimit të paketimit**

(1) Tregtari ka të njëjtat detyrime për pranimin e kthimit të paketimit, si prodhuesi në përputhje me nenin 20 të këtij ligji.

(2) Tregtari nuk duhet të ketë licencë për menaxhim të mbeturinave të paketimit, në përputhje me rregulloret për menaxhimin e mbeturinave, për hapsirat e tij për pranimin e kthimit ose vendet për marrjen e mbeturinave të paketimit.

(3) Tregtari është i detyruar t'ia dorëzojë mbeturinat e mbledhura të paketimit pa i modifikuar ato grumbulluesit ose operatorit të menaxhimit të mbeturinave i cili është pjesë e vepruesit kolektiv, me transport dhe formularë të identifikimit të detyrueshëm në përputhje me rregulloret e menaxhimit të mbeturinave.

(4) Tregtari për përmbushjen e detyrimeve sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, lidh marrëveshje me veprues kolektiv me kohëzgjatje të paktën një vit kalendarik, i cili rregullon të drejtat dhe detyrimet për dorëzimin e mbeturinave të paketimit të marra ose të krijuara në hapsirat e tyre.

(5) Mbeturinat e paketimit që merren përsëri ose krijohen nga tregtari llogariten në qëllimet kombëtare për grumbullimin e mbeturinave të paketimit të përcaktuara në nenin 21 të këtij ligji.

(6) Detyrimi për pranimin e kthimit të tregtarit nuk mund të barten nga tregtari në një subjekt tjetër.

(7) Tregtari vetëm ose në marrëveshje me prodhuesin, mund të inkurajojë shfrytëzuesit e fundit që të kthejnë mbeturinat e paketimit në mënyrë që të rrisin shpërndarjen e mbeturinave të paketimit nëpërmjet ofertave për zbritje gjatë blerjes së produkteve të reja të paketuara, ose masa të tjera stimuluese.

### **Neni 28**

#### **Marrja e mbeturinave të paketimit nga tregtari**

(1) Tregtari, në marrëveshje me prodhuesin, mund të mundësojë kthimin e mbeturinave të paketimit në vendet ku mundësohet marrja nga prodhuesi.

(2) Marrja e mbeturinave të paketimit në mënyrën e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni nuk ndikon në detyrimet e tregtarit sipas nenit 27 të këtij ligji.

(3) Prodhuesi është i detyruar pa kompensim të marrë përsipër mbeturinat e paketimit nga tregtari dhe tregtari nuk mund të kërkojë kompensim për marrjen e mbeturinave të paketimit nga prodhuesi.

### **Neni 29**

#### **Evidentimi si detyrim i tregtarit**

(1) Tregtari është i detyruar të mbajë evidencë për sasinë e mbeturinave të paketimit të marra sipas llojit dhe kategorisë.

(2) Evidentimet sipas paragrafit (1) të këtij neni duhet të jenë në dispozicion në hapsirat e tregtarit ku kryhet tregtia dhe duhet të jenë në dispozicion në çdo kohë për organet kompetente sipas nenit 40 të këtij ligji.

(3) Tregtari është përgjegjës për gjithë përfshirjen dhe saktësinë e të dhënave të paraqitura me evidencën sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Tregtari, për mallrat e paketuara që shet, është i detyruar të sigurojë nga prodhuesi nga i cili janë sjellë mallrat, vërtetim nga sistemi kolektiv për menaxhimin e paketimit dhe mbeturinave të paketimit, gjegjësisht vërtetim se prodhuesi ka paguar kompensimin sipas nenit 35 të këtij ligji.

(5) Ministri që udhëheq organin për mjedisin jetësor, përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit për mbajtjen e evidencës sipas paragrafit (1) të këtij neni.

#### **IV. DETYRIMET E PALËVE TË TJERA TË PREKURA**

##### **Neni 30**

##### **Kushtet për t'u bashkuar sistemit të vepruesit kolektiv**

(1) Personat juridikë ose fizikë, të cilët me veprimtarinë e tyre posedojnë mbeturina nga paketimi, mund të bashkohen në sistemit të vepruesit kolektiv të mbeturinave të paketimit, duke zbatuar masat dhe aktivitetet në lidhje me:

- sigurimi i hapësirës dhe kontejnerëve përkatës për grumbullimin e mbeturinave të paketimit dhe

- vendosje të njoftimeve dhe informacioneve sipas nenit 24 të këtij ligji për shfrytëzuesit e fundit.

(2) Subjektet sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk janë të detyruar të posedojnë leje për menaxhim të mbeturinave në përputhje me rregulloret e menaxhimit të mbeturinave për aktivitetet sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Subjektet sipas paragrafit (1) të këtij neni janë të detyruara të dorëzojnë mbeturinat e grumbulluara të paketimit pa i modifikuar ato në grumbullues ose operator për menaxhimin e mbeturinave i cili është pjesë e vepruesit kolektiv, me formularë të detyrueshme të transportit dhe identifikimit në përputhje me rregulloret e menaxhimit të mbeturinave.

(4) Vepruesi kolektiv dhe subjektet sipas paragrafit (1) të këtij neni rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella, mënyrën e marrjes dhe dorëzimit të paketimeve dhe mbeturinave nga paketimi të përdorura duke lidhur marrëveshje për bashkëngjitje në sistemin me pëlqim të ndërsjellë.

##### **Neni 31**

##### **Detyrimet për shfrytëzuesit e fundit**

(1) Shfrytëzuesi i fundit mbledh, ruan dhe i dorëzon prodhuesit, tregtarit ose grumbulluesit të autorizuar i cili është pjesë e vepruesit kolektiv për mbeturinat e paketimit, mbeturinat e krijuara të paketimit si pjesë e fraksionit të grumbulluar veçmas të mbeturinave komunale ose i dorëzon mbeturinat e paketimit në qendër grumbullimi ose vendi i takimit i caktuar për këtë qëllim.

(2) Shfrytëzuesi i fundit është i detyruar para se ti dorëzojë mbeturinat e paketimit, t'i grumbulloj ato dhe t'i mbajë ato veçmas, në mënyrë që të mos bie në kontakt me lloj tjetër të mbeturinave, të mos përzihet ose në mënyrë tjetër të shkatërrojë ose ndotë me substanca të rrezikshme ose të tjera, gjë që do të parandalonte riciklimin ose përpunimin e tij.

##### **Neni 32**

##### **Detyrimet e kryetarit të komunës**

(1) Kryetari i komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, është i detyruar:

- të organizojë grumbullimin e veçantë të mbeturinave të paketimit nga amvisëritë,
- të organizojë grumbullimin e mbeturinave të paketimit nga amvisëritë nga ofruesi i autorizuar i shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave komunale, si fraksion i veçantë i grumbullimit të mbeturinave komunale,
- të përcaktojë dhe organizojë pikat e grumbullimit për grumbullimin e veçantë të mbeturinave të paketimit nga amvisëritë në qendrat e grumbullimit ose në vendet e tjera të përcaktuara përkohësisht për atë qëllim në të gjithë zonën e komunës, komunës në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, ku shfrytëzuesit e fundit mund ti lënë pa pagesë mbeturinat e paketimeve të amvisërive dhe

-të bashkëpunojë me vepruesit kolektivë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesit për menaxhimin e rrjedhave të veçanta të mbeturinave.

(2) Gjatë përcaktimit të vendeve dhe lokacioneve të qendrave të grumbullimit, duhet të merret parasysh numri i banorëve në vendbanim, me të cilin duhet të sigurohet së paku një qendër grumbullimi në nivelin komunal, përkatësisht të paktën një qendër grumbullimi për të paktën 30,000 banorë për komuna që kanë më shumë se 30,000 banorë.

(3) Qendrat e grumbullimit sipas paragrafit (2) të këtij neni përfshijnë edhe vendet dhe lokacionet ekzistuese për pranimin e fraksioneve të grumbulluara veçmas të mbeturina komunale, nëse këto vende plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë ligj ose rregulloret e menaxhimit të mbeturinave.

(4) Mbeturinat e paketimit të grumbulluara veçmas në vendet e caktuara sipas paragrafit (1) nënparagrafi 3 të këtij neni do t'i dorëzohen falas vepruesit kolektiv të mbeturinave të paketimit në bazë të marrëveshjes së lidhur me komunën, komunat në qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit, gjegjësisht menaxhimi i mbeturinave në rajonin përkatës të planifikimit i themeluar në përputhje me Ligjin e Menaxhimit të Mbeturinave.

5) Në marrëveshje sipas paragrafit (4) të këtij neni rregullohen të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të palëve kontraktuese, mënyrën e grumbullimit të rregullt të mbeturinave të paketimit, mënyrën e informimit të publikut për qendrat e grumbullimit dhe lokacionet tjera për grumbullim të mbeturinave të paketimit, mënyrën si të mbuluar shpenzimet e punës dhe çështje të tjera me interes të përbashkët. Marrëveshja lidhet për periudhë prej të paktën një viti.

### **Neni 33 Dorëzania**

(1) Për të inkurajuar kthimin dhe grumbullimin e mbeturinave të paketimit, prodhuesi mund të vendosë sistem të dorëzansisë për paketimin e produktit të tij, i cili paguhet në vendin e shitjes së mallit të pakeluar.

(2) Shuma e dorëzansisë sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk duhet të kalojë shumë prej 30% të çmimit të shitjes së mallit të pakeluar dhe do të shfaqet veçmas në faturë gjatë shitjes së produktit në paketim, që përfshihet në sistem e dorëzansisë.

(3) Prodhuesi i cili vendos sistemin e dorëzansisë për paketimin e produktit të tij, është i detyruar të:

- shënojë qartë dhe dukshëm paketimin e përfshirë nga sistemi i dorëzansisë;
- organizojë pranim të kthimit të paketimit nga tregtarët dhe shfrytëzuesit e fundit dhe të paguajë shumë e përgjithshme nga depoziti, dhe
- përcaktojë qartë kushtet për tregtarin dhe shfrytëzuesin e fundit se çfarë duhet të jetë vetë paketimi që është e pranueshme për sistemin e dorëzansisë.

(4) Prodhuesi, të paktën gjashtë muaj para fillimit të sistemit të dorëzansisë është i detyruar të regjistrojë në organin profesional prodhimet e përfshira në sistemin e dorëzansisë si dhe shumë e depozitës sipas njësisë së paketimit.

(5) Regjistrimi sipas paragrafit (4) të këtij neni përfshin të dhënat e mëposhtme:

- emrin, selinë dhe numrin tatimor të prodhuesit;
- emrin e saktë të prodhimit që është në paketim dhe është përfshirë në sistemin e dorëzansisë;
- numrin e vetëm të identifikimit të prodhimit (numri GTIN);
- mënyrën e njoftimit të publikut për sistemin dhe funksionimin e tij dhe
- shumë e dorëzansisë sipas njësisë.

(6) Organi profesional është i detyruar të mbajë regjistër të prodhimeve të përfshira në sistemin e dorëzansisë sipas prodhuesit.

(7) Prodhuesi është i detyruar ta njoftojë organin profesional për qëllimin për të ndërprerë sistemin e dorëzansisë më së voni gjashtë muaj para se ta ndërpresë atë.

(8) Prodhuesi i cili ka ndërprerë sistemin e dorëzarisë është i detyruar të vazhdojë me pagesën e garancisë për tregtarët dhe / ose shfrytëzuesit e fundit brenda një viti nga përfundimi i këtij sistemi.

(9) Tregtari, nëse posedon hapësirë të shitjes më të madhe se 200 m<sup>2</sup> ku shiten mallrat e paketuara në paketim të përfshirë në çfarëdo sistem të dorëzarisë, do të ofrojë pranim të kthimit të paketimit dhe pagesën e dorëzarisë në të njëjtat kushte dhe në të gjithë kohëzgjatjen e orët e punës së vendit të shitjes.

(10) Tregtari është i detyruar të shënojë qartë vendin ku kryhet pranimi i kthimit të paketimit brenda sistemit të dorëzarisë.

(11) Tregtari është i detyruar të paguajë shumën e përgjithshme të dorëzarisë në para kesh ose në kupon në shumën e dorëzarisë së shfrytëzuesit të fundit pasi shfrytëzuesi i fundit të ketë kthyer paketimin në vendin e përcaktuar në atë pikë të shitjes.

(12) Tregtari është i detyruar të kthejë paketimin në sistemin e dorëzarisë pa i nënshtruar ndonjë ndryshim.

(13) Prodhuesi është i detyruar të financojë sistemin e plotë të dorëzarisë së tregtarit, për paketimet e tij të përfshira në sistemin e dorëzarisë.

(14) Tregtari nuk ka të drejtë në kërkesa për ndonjë shpenzim shtesë për shkak të pjesëmarrjes në sistemin e dorëzarisë, përveç shpenzimeve sipas paragrafit (13) të këtij neni.

## **V. DETYRIMET E ORGANEVE SHTETËRORE**

### **Neni 34**

Baza e të dhënave dhe sistemi informativ

(1) Organi i mjedisit jetësor është i detyruar të krijojë dhe mirëmbajë bazë elektronike të të dhënave për paketimin që lëshohet në treg në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për të dhënat për trajtimin e mbeturinave të paketimit në përputhje me dispozitat e rregulloreve për përgjegjësi të zgjatur të prodhuesit me rrjedha të veçanta të mbeturinave.

(2) Baza e të dhënave sipas paragrafit (1) të këtij neni mbahet në bazë të të dhënave nga raportet e paraqitura në pajtim me nenin 19 të këtij ligji dhe në veçanti përmban të dhënat për:

1) sasi të e paketimeve të vendosura në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas llojit të materialit paketues;

2) sasi të e mbeturina të grumbulluara të paketimit sipas llojit dhe kategorisë;

3) sasi të e mbeturina të paketuara të depozituara sipas llojit të materialit;

4) sasi të e mbeturinave të paketimit sipas llojit dhe materialit që menaxhohen dhe mënyrën e menaxhimit (ripërdorimi, riciklimi dhe mënyrë tjetër e përpunimit);

5) sasi të e mbetjeve të mbeturinave të paketimit të të hequra nëpërmjet deponimit;

6) sasi të e mbeturina të paketimit të eksportuara jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut sipas llojit të materialit dhe

7) vetitë e mbeturinave të paketimit (rreziku dhe dëmtimi i materialeve nga të cilat është bërë paketimi).

(3) Baza e të dhënave sipas paragrafit (1) të këtij neni përmban informata për paketimin e vendosur në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të dhëna për menaxhimin e mbeturinave të paketimit për të paktën pesë vitet e mëparshme.

(4) Baza e të dhënave sipas paragrafit (1) të këtij neni përmban të dhëna për secilin subjekt në nivel vjetor.

(5) Në bazë të të dhënave sipas paragrafit (2) të këtij neni, organi i mjedisit jetësor më së voni deri më 1 shtator të vitit aktual do të publikojë raport mbi sasi të dhe llojin e paketimit të

lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe mbi sasi të, llojin dhe mënyrën e trajtimit të mbeturina të paketimit për vitin paraprak.

(6) Të dhënat e grumbulluara në bazë të paragrafit (2) të këtij neni do të përpunohen dhe bëhen të vlefshme nga organi i mjedisit jetësor nëpërmjet sistemit të vendosur informativ për paketimin dhe mbeturinat e paketimit, i cili është pjesë përbërëse e sistemit të informativ të mjedisit jetësor.

(7) Të dhënat e përpunuara dhe të vërtetuara sipas paragrafit (6) të këtij neni do t'i paraqiten Komisionit Europian dhe trupave dhe organeve të tjera të Bashkimit Europian dhe ato do të jenë të qasshme për publikun.

### **Neni 35**

#### **Kompensim i menaxhimit të mbeturinave të paketimit**

(1) Prodhuesi dhe prodhuesi i cili si shfrytëzues i fundit lëshon në treg të Republikës së Maqedonisë së Veriut mallra të paketuara nga të cilat krijohen mbeturina paketimi gjatë përdorimit, është i detyruar të paguajë kompensim për menaxhimin e mbeturinave të paketimit (në tekstin në vijim: kompensimi).

(2) Shuma e kompensimit sipas paragrafit (1) të këtij neni sipas llojit të materialit është:

1) 7,400 denarë / ton për letër dhe dru, dhe

2) 9.200 denarë / ton për plastikë, metal, përbërës dhe qelq.

(3) Kompensimi sipas paragrafit (1) të këtij neni llogaritet në bazë të peshës neto të paketimit që lëshohet në treg sipas llojit të materialit të shprehur në ton, për të cilën përgatitet llogaritja kuartale në formular të veçantë, edhe kur prodhuesi nuk ka lëshuar prodhime në treg gjatë këtij kuartali.

(4) Detyrimi për llogaritjen e kompensimit për prodhuesin ndodh në momentin kur produkti i pakeluar për herë të parë është hedhur në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përkatësisht në momentin e shitjes së qeseve biodegraduese për bartjen e mallrave me shfrytëzuesin përfundimtar .

(5) Detyrimi për të llogaritur kompensimin për prodhuesin i cili si shfrytëzues i fundi lëshon në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut mallra të paketuara nga të cilat gjatë përdorimit krijohen mbeturina nga paketimi, ndodh në momentin kur produkti i pakeluar lëshohet në tregun në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(6) Prodhuesi dhe prodhuesi i cili si shfrytëzues i fundit lëshon në treg të Republikës së Maqedonisë së Veriut mallra të paketuara nga të cilat krijohen mbeturina paketimi gjatë përdorimit është i detyruar të paguajë kompensim të përcaktuar çdo 15 ditë të kuartalit aktual të vitit për të gjitha kompensimet e llogaritura për kuartalin paraprak.

(7) Mjetet nga kompensimi sipas paragrafit (2) të këtij neni do të jenë të ardhura të organit të mjedisit jetësor dhe do të paguhet në llogari të veçantë pagesore.

(8) Kompensimi nuk paguhet nëse produkti i pakeluar eksportohet ose produkti i pakeluar që është i lëshuar në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut shkatërrohet pas tërheqjes nga tregu pa u përdorur i njëjti në vitin aktual, për të cilin prodhuesi duhet të dorëzojë tek organi profesional dëshmi përkatëse.

(9) Në rastin e paragrafit (8) të këtij neni, prodhuesi dhe prodhuesi i cili si shfrytëzues i fundit lëshon në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut mallra të paketuara nga të cilat gjatë përdorimit krijohen mbeturina nga paketimi është i detyruar të sigurojë deklaratë elektronike doganore të eksportit në përputhje me rregulloret e punës doganore si dëshmi se sasia e paketimit për të cilën nuk është llogaritur kompensim është eksportuar jashtë vendit ose të sigurojë dokument nga i cili duket se produktet e paketuara janë shkatërruar.

(10) Në rast të eksportit ose shkatërrimit të produkteve të paketuara për të cilat është paguar kompensim, prodhuesi dhe prodhuesi i cili si shfrytëzues i fundit lëshon në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut mallra të paketuara nga të cilat gjatë përdorimit krijohen

mbeturina nga paketimi, ka të drejtë kthimi të kompensimit të paguar për sasinë e paketuar të eksportuar ose të shkatërruar në afat prej pesë vitesh nga pagesa e kompensimit.

(11) Për kthimin e kompensimit sipas paragrafit (10) të këtij neni, prodhuesi dhe prodhuesi i cili si shfrytëzues i fundit lëshon në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut mallra të paketuara nga të cilat gjatë përdorimit krijohen mbeturina nga paketimi te organi profesional parashtrajnë kërkesë në formular të veçantë bashkë me llogaritjen tremujore sipas paragrafit (3) të këtij neni për tremujorin e ardhshëm, në të cilin do të përmenden arsyet për kthim të kompensimit.

(12) Kthimi i kompensimit sipas paragrafit (10) të këtij neni kryhet me aktvendim të organit profesional pas hulumtimit të dokumentacionit të dorëzuar dhe të kontrollimit nëse janë përmbushur kushtet për kthim të kompensimit të paguar në përputhje me paragrafin (11) të këtij neni.

(13) Aktvendimi i organit profesional sipas paragrafit (12) të këtij neni do të miratohet në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për kthim të kompensimit sipas paragrafit (11) të këtij neni.

(14) Kundër aktvendimit të organit profesional sipas paragrafit (12) të këtij neni mund të parashtrohet ankesë në përputhje me rregulloret për procedurën e përgjithshme administrative.

(15) Pas hyrjes në fuqi të aktvendimit të organit profesional sipas paragrafit (12) të këtij neni, organi i mjedisit jetësor bën kthimin e kompensimit.

(16) Ministri që udhëheq organin e mjedisit jetësor në përputhje me ministrin që udhëheq organin e administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve në fushën e financave cakton formën dhe përmbajtjen e formularit në paragrafin (3) të këtij neni, si dhe mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për kthimin e kompensimit, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit sipas paragrafit (11) të këtij neni.

### **Neni 36**

#### **Detyrimi për mënyrën e llogaritjes, pagesës si dhe për mbajtjen e evidencës për kompensimin e llogaritur dhe të paguar**

1) Prodhuesi dhe prodhuesi i cili si shfrytëzues i fundit lëshon në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut mallra të paketuara nga të cilat gjatë përdorimit krijohen mbeturina nga paketimi (në tekstin e mëtejshëm: obliguesi), është i detyruar kompensimin sipas nenit 35 paragrafi (2) të këtij ligji në kohë dhe të llogarit dhe paguaj drejt, si dhe të mbajë, mirëmbajë dhe ruajë evidencë të rregullt dhe të saktë të kompensimit të llogaritur dhe të paguar.

(2) Në bazë të evidencës sipas paragrafit (1) të këtij neni, obliguesi përpilon dhe çdo tre muaj dorëzon te organi profesional llogaritjen për kompensimin e paguar në formular të veçantë dhe në rast se nuk ka lëshuar produkte të paketuara në treg gjatë këtij tremujori.

(3) Organi profesional llogaritjet për kompensimin e paguar i kontrollon dhe nëse përcakton pagesë të papërshtatshme të kompensimit, me aktvendim përcakton shumën e saktë për të cilën duhet të paguhet kompensimi.

(4) Kundër aktvendimit sipas paragrafit (3) të këtij neni mund të parashtrohet ankesë në përputhje me rregulloret e procedurës së përgjithshme administrative.

(5) Ministri që udhëheq organin e mjedisit jetësor në përputhje me ministrin që udhëheq organin e administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve në fushën e financave caktojnë mënyrën e mbajtjes, mirëmbajtjes dhe ruajtjes së evidencës sipas paragrafit (1) të këtij neni, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit sipas paragrafit (2) të këtij neni.

### **Neni 37**

#### **Lirimi nga pagesa e kompensimit**

Nga pagesa e kompensimit sipas nenit 35 paragrafi (2) të këtij ligji lirohen subjektet e mëposhtme:

1) prodhuesi dhe prodhuesi i cili si shfrytëzues i fundit lëshon në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut mallra të paketuara nga të cilat gjatë përdorimit krijohen mbeturina nga paketimi, nëse kanë lidhur kontratë për ndërmarrjen e obligimeve për veprim me mbeturinat e paketimit me veprues kolektiv për veprim me mbeturinat e paketimit që posedon leje në përputhje me rregulloret për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit për menaxhimin e rrjedhave të veçanta të mbeturinave dhe

2) prodhuesi i përcaktuar si prodhues i vogël në përputhje me nenin 26 të këtij ligji.

### **Neni 38**

#### **Shfrytëzimi i kompensimit**

Mjetet e mbledhura nga kompensimi sipas nenit 35, paragrafi (2) të këtij ligji përdoren për financimin dhe zbatimin e masave dhe aktiviteteve për menaxhimin e mbeturinave të përcaktuara me dokumentet strategjike dhe të planifikuara, të cilat janë të drejtuara drejt arritjes së qëllimeve të këtij ligji në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar në përputhje me rregulloret për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit për menaxhimin e rrjedhave të veçanta të mbeturinave.

### **Neni 39**

#### **Marrëveshje vullnetare**

Organizatrat që përfaqësojnë interesa të caktuar të operatorëve ekonomikë dhe grupe të operatorëve ekonomikë të përfshira me këtë ligj, mund të aderojnë në lidhjen e marrëveshjes vullnetare me organin e mjedisit jetësor ose Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut nëpërmjet së cilës do të rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e njëra-tjetrës për të arritur qëllime më të larta kombëtare sipas nenit 21 të këtij ligji, si dhe shkallë më të lartë të riciklimit, ripërpunimit dhe përpunimit dhe për futjen e sistemeve të certifikuara të menaxhimit të mjedisit jetësor në mënyrë siç është përcaktuar në rregulloret për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit për menaxhimin e mbeturinave.

## **VI. MBIKQYRJA DHE ORGANET KOMPETENTE**

### **Neni 40**

#### **Organet kompetente**

(1) Mbikëqyrja mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregulloreve të miratuara në bazë të këtij ligji kryhet nga organi i mjedisit jetësor.

(2) Mbikëqyrja inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregulloreve të miratuara në bazë të këtij ligji kryhet nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor, nëpërmjet inspektorëve shtetërorë të mjedisit jetësor.

(3) Mbikëqyrja mbi evidencat dhe njoftimet në përputhje me nenin 19 të këtij ligji, kryhet nga organi profesional.

(4) Mbikëqyrja inspektuese mbi aplikimin dhe zbatimin e këtij ligji në pikëpamje të detyrimeve nga ky ligj që rrjedhin për tregtarët kryhet nga inspektorët e autorizuar për mjedisin jetësor të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit.

(5) Mbikëqyrja inspektuese mbi aplikimin dhe zbatimin e këtij ligji në pikëpamje të nivelit të përqëndrimit të metaleve të rënda në paketim, shënimin e paketimeve, qarkullimin me qese plastike dhe informimin e konsumatorëve kryhet nga Inspektorati Shtetëror i Tregut.

(6) Mbikëqyrja inspektuese mbi aplikimin dhe zbatimin e këtij ligji në pikëpamje të lënies ose dorëzimit të mbeturinave të paketimit si pjesë e mbeturinave komunale kryhet nga inspektorët komunalë të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit.

## Neni 41

### Fushëveprimi i mbikëqyrjes së inspektorit shtetëror të mjedisit jetësor

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes nga fushëveprimi i tij, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor kryen inspektim dhe kontroll:

- 1) nëse prodhohen dhe/ose lëshohen në treg paketime që nuk i përmbushin kërkesat në lidhje me prodhimin dhe përbërjen e paketimit (neni 11 të këtij ligji);
- 2) nëse paketimi që prodhohet dhe/ose lëshohet në treg me qëllim të ripërdorimit, është përpunuar në përputhje me nenin 12 të këtij ligji;
- 3) nëse paketimi që prodhohet dhe/ose lëshohet në treg është në përputhje me kërkesat e nenit 13 të këtij ligji;
- 4) nëse prodhohen dhe/ose lëshohen në treg paketime që nuk prodhohen në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane për prodhimin e paketimit (neni 15 të këtij ligji);
- 5) nëse prodhuesi është i regjistruar e organi profesional (neni 17 të këtij ligji);
- 6) nëse prodhuesi që nuk është i regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe lëshon produkte në treg nëpërmjet komunikimit në distancë (tregti elektronike) ka caktuar përfaqësues të autorizuar (neni 18 të këtij ligji);
- 7) nëse detyrimet për evidencë dhe raportet vjetore janë përmbushur në përputhje me nenin 19 të këtij ligji;
- 8) nëse prodhuesi siguron pranim të kthyeshëm të paketimit të shitur, grupor dhe transportues (neni 20 të këtij ligji);
- 9) nëse prodhuesi siguron realizimin e qëllimeve kombëtare sipas nenit 21 të këtij ligji, të cilat kanë të bëjnë me mbledhjen, riciklimin dhe përpunimin e mbeturinave nga paketimi;
- 10) nëse përcaktohen qëllimet vjetore për mbledhjen, riciklimin dhe përpunimin sipas kategorisë së mbeturinave në kilograme në afat të caktuar (neni 21 paragrafi (6) të këtij ligji);
- 11) nëse prodhuesi siguron financimin e shpenzimeve për aktivitetet në përputhje me nenin 22 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 12) nëse prodhuesi i vogël ka paguar kompensim paushall (neni 22 paragrafi (2) të këtij ligji);
- 13) nëse prodhuesi, shpenzimet për veprim me mbeturinat e paketimit i paraqet në përputhje me nenin 22 paragrafi (3) të këtij ligji;
- 14) nëse prodhuesi ka siguruar garanci financiare për zbatimin e obligimeve për mbledhjen, trajtimin dhe përpunimin (neni 23 të këtij ligji);
- 15) nëse prodhuesi siguron përmbushjen e obligimeve dhe qëllimeve të këtij ligji nëpërmjet kthimit, mbledhjes dhe përpunimit në shpenzim të tij (neni 25 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji);
- 16) nëse prodhuesi ka lidhur marrëveshje për ndërmarrjen e obligimeve për veprim me mbeturinat nga paketimi me veprues kolektiv (neni 25 paragrafi (3) të këtij ligji);
- 17) nëse prodhuesi i cili lëshon në treg produkte të paketuara të njëjta ose më të vogla se sasitë në nenin 26 paragrafi (1) të këtij ligji, është regjistruar si prodhues i vogël dhe nëse mban evidencë dhe dorëzon raporte në përputhje me nenin 26 paragrafi (2) të këtij ligji;
- 18) nëse prodhuesi dorëzon të dhëna të sakta për t'u përcaktuar si prodhues i vogël (neni 26 paragrafi (3) të këtij ligji);
- 19) nëse dorëzohen mbeturinat nga paketimi pa modifikim dhe nëse veprohet në përputhje me nenin 30 paragrafi (3) të këtij ligji dhe
- 20) kryen dhe punë të tjera në kompetencë të tij të përcaktuara në këtë ligj.

(2) Në kërkesën e inspektorit shtetëror të mjedisit jetësor, në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese mund të marrë pjesë edhe nëpunësi civil kompetent i punësuar në organin profesional.

(3) Inspektori shtetëror i mjedisit jetësor është i detyruar të kryejë mbikëqyrje inspektuese, kur atë do ta kërkojë organi profesional pa shtyrje.

## Neni 42

### Miratimi i aktvendimeve nga Inspektori Shtetëror i Mjedisit Jetësor

(1) Gjatë kryerjes së mbikqyrjes inspektuese, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor me aktvendim:

1) do t'i detyrojë prodhuesit paketimi që prodhohet dhe/ose lëshohet në treg t'i përmbushë kërkesat në lidhje me prodhimin dhe përbërjen e paketimit në përputhje me nenin 11 të këtij ligji;

2) do t'i detyrojë prodhuesit paketimi që prodhohet dhe/ose lëshohet në treg me qëllim të ripërdorimit të tij të përpunohet në përputhje me nenin 12 të këtij ligji;

3) do t'i detyrojë prodhuesit paketimi që prodhohet dhe/ose lëshohet në treg të jetë në përputhje me kërkesat sipas nenit 13 të këtij ligji;

4) do t'i detyrojë prodhuesit të prodhojnë dhe/ose lëshojnë në treg paketime që prodhohen në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane për prodhimin e paketimit (neni 15 të këtij ligji);

5) do t'i detyrojë prodhuesit të regjistrohen në përputhje me nenin 17 të këtij ligji;

6) do t'i detyrojë prodhuesit që nuk janë të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe që lëshojnë produkte në treg nëpërmjet komunikimit në distancë (tregti elektronike), të caktojnë përfaqësues të autorizuar (neni 18 të këtij ligji);

7) do t'i detyrojë prodhuesit të veprojnë dhe të ndërmarrin obligimet në përputhje me nenin 19 të këtij ligji;

8) do t'i detyrojë prodhuesit të përmbushin detyrimet për pranim të kthyeshem të paketimi të shitur, grupor dhe transportues (neni 20 të këtij ligji);

9) do t'i detyrojë të sigurojnë mbledhjen, riciklimin dhe përpunimin e mbeturinave nga paketimi për realizimin e qëllimeve kombëtare sipas nenit 21 të këtij ligji;

10) do t'i detyrojë prodhuesit të përcaktojnë qëllimet vjetore për mbledhjen, riciklimin dhe përpunimin sipas kategorisë së mbeturinave në kilograme në afat të caktuar (neni 21 paragrafi (6) të këtij ligji);

11) do t'i detyrojë prodhuesit të financojnë shpenzimet për aktivitetet në përputhje me nenin 22 paragrafi (1) të këtij ligji,

12) do t'i detyrojë prodhuesit e vegjël të paguajnë kompensim paushall në përputhje me nenin 22 paragrafi (2) të këtij ligji;

13) do t'i detyrojë prodhuesit shpenzimet për veprim me mbeturina e paketimit ti paraqes në përputhje me nenin 22 paragrafi (3) të këtij ligji;

14) do t'i detyrojë prodhuesit të sigurojnë garanci financiare për zbatimin e detyrimeve për mbledhje, trajtim dhe përpunim në përputhje me nenin 23 të këtij ligji;

15) do t'i detyrojë prodhuesit të sigurojnë përmbushjen e detyrimeve dhe qëllimeve të këtij ligji nëpërmjet kthimit, mbledhjes dhe përpunimit të shpenzimit të vet në përputhje me nenin 25 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji;

16) do t'i detyrojë prodhuesit të lidhin kontratë për ndërmarrjen e detyrimeve për veprim me mbeturina të paketimit me veprues kolektiv në përputhje me nenin 25 paragrafi (3) të këtij ligji nëse nuk kanë paguar dhe nuk kanë qëllim të paguajnë kompensim për menaxhim të mbeturinave nga paketimi;

17) do të detyrojë prodhuesin i cili lëshon në treg produkte të paketuara të njëjta ose më të vogla se sasi të nenin 26 paragrafi (1) të këtij ligji, të regjistrohet si prodhues i vogël dhe të mbajë evidencë dhe të dorëzojë raporte në përputhje me nenin 26 paragrafi (2) të këtij ligji;

18) do ti detyrojë prodhuesit e vegjël të dorëzojnë të dhëna të sakta te organi profesional nëse ata dorëzojnë të dhëna të pasakta për t'u përcaktuar si prodhues i vogël në përputhje me nenin 26 paragrafi (3) të këtij ligjidhe

19) do ti detyrojë personat juridik dhe fizik që të dorëzojnë mbeturinat e paketimit pa modifikime dhe të veprojnë në përputhje me nenin 30 paragrafi (3) të këtij ligji.

(2) Nëse gjatë mbikqyrjes inspektuese inspektori shtetëror i mjedisit jetësor përcakton se subjektet e mbikqyrjes nuk i përmbahen kërkesave të këtij ligji, me procesverbal do ti konstatojë parregullsitë e përcaktuara dhe në aktvendim do të përcaktojë masat dhe aktivitetet përkatëse që

duhet të merren për të kapërcyer situatën e krijuar, si dhe do të përcaktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë për të hequr shkaqet e gjendjes së krijuar.

(3) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor subjekteve të mbikëqyrjes u vendos ndalim të përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 15 ditë, për parregullsitë e përcaktuara sipas paragrafit (1) pikat 9), 10), 11) 16) dhe 18) të këtij neni.

(4) Kundër aktvendimit të inspektorit shtetëror të mjedisit jetësor mund të deklarohet ankesë në përputhje me rregulloren e mbikëqyrjes inspektuese.

(5) Nëse subjektet sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk veprojnë në përputhje me aktvendimin e inspektorit shtetëror të mjedisit jetësor dhe nuk heqin arsyet për situatën e krijuar me aktvendim, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor do të parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje te organi kompetent i kundërvajtjes.

(6) Në rastin kur do të përcaktohet ekzistimi i rrezikut të drejtëpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e njerëzve, inspektori do të lëshojë urdhër me gojë për heqjen urgjentisht dhe të menjëhershme të çrregullimeve të përcaktuara dhe parregullsive të cilat në procesverbal i konstaton në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor, si dhe do të njoftojë inspektorët e tjerë kompetentë ose organet e tjera shtetërore për parregullsitë e përcaktuara dhe do të kërkojë ndërhyrjen e tyre.

(7) Nëse çrregullimet dhe parregullsitë e konstatuara sipas paragrafit (6) të këtij neni, paraqesin rrezik për rrezikimin e mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve, inspektori menjëherë do të ndalojë punën e instalimit, objektit, makinerisë, pajisjes, si dhe përdorimin e mjeteve dhe të pajisjeve për kryerjen e veprimtarisë.

(8) Në rastet sipas paragrafit (6) të këtij neni, inspektori miraton aktvendim me shkrim në afat prej 48 orëve nga lëshimi i urdhrimit me gojë.

(9) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes sipas paragrafit (1) të këtij neni inspektori shtetëror i mjedisit jetësor ka të drejtë që të ndërmarrë edhe masa të tjera të përcaktuara me rregulloret për mjedisin jetësor dhe rregulloret për mbikëqyrjen inspektuese.

#### **Neni 43**

##### **Fushëveprimi i mbikëqyrjes së inspektorëve të autorizuar për mjedisin jetësor të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit dhe inspektorëve komunal të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit**

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes në fushëveprimin e tij, inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, kryen inspektim dhe kontroll:

1) nëse tregtari me paketimin e shitur, grupor dhe transportues vepron në përputhje me nenin 27 të këtij ligji;

2) nëse mbeturinat nga paketimi janë marrë në përputhje me nenin 28 paragrafi (3) të këtij ligji;

3) nëse tregtari mban evidencë për sasi të mbeturinave të marra nga paketimi (neni 29 të këtij ligji) dhe

4) nëse tregtari për mallrat e paketuara që shet ka siguruar vërtetim nga prodhuesi për veprim me mbeturinat nga paketimi (neni 29 paragrafi (4) të këtij ligji).

(2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes në fushëveprimin e tij, inspektori komunal i komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, kryen inspektim dhe kontroll:

1) nëse shfrytëzuesi i fundit me mbeturinat nga paketimi të cilat janë mbeturina komunale vepron në përputhje me nenin 31 paragrafi (1) të këtij ligji dhe

2) nëse shfrytëzuesi i fundit para se të dorëzojë mbeturinat nga paketimi të cilat janë mbeturina komunale i mbledh dhe i ruan në mënyrën e përcaktuar në nenin 31 paragrafi (2) të këtij ligji.

#### **Neni 44**

##### **Miratimi i aktvendimeve të inspektorëve të autorizuar për mjedisin jetësor të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit dhe inspektorëve komunalë të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit.**

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit me aktvendim:

1) do t'i detyrojë tregtarët me paketimin e shitur, grupor dhe transportues të veprojnë në përputhje me nenin 27 të këtij ligji;

2) do t'i detyrojë tregtarët dhe prodhuesit marrjen e mbeturinave nga tregtari ta bëjnë në përputhje me mënyrën e nenit 28 paragrafi (3) të këtij ligji;

3) do t'i detyrojë tregtarët të mbajnë evidencë për sasi të e mbeturinave të marra nga paketimi (neni 29 të këtij ligji) dhe

4) do t'i detyrojë tregtarët të kërkojnë dhe të sigurojnë vërtetim nga prodhuesi për veprim me mbeturinat e paketimit (neni 29 paragrafi (4) të këtij ligji).

(2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori komunal i komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit me aktvendim:

1) do t'i detyrojë shfrytëzuesit e fundit të veprojnë me mbeturinat nga paketimi në përputhje me nenin 31 paragrafi (1) të këtij ligji dhe

2) do t'i detyrojë shfrytëzuesit e fundit mbeturinat nga paketim të mbledhin ose të ruajnë veçmas që të mos përzihen ose në mënyrë tjetër të mos shkatërrohen ose rrezikohen me substanca të rrezikshme ose të tjera që parandalojnë riciklimin ose përpunimin e të njëjtave (neni 31 paragrafi (2) të këtij ligji).

(3) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni përcaktojnë se subjektet e mbikëqyrjes nuk i përmbahen kërkesave të këtij ligji, me procesverbal do të konstatojnë parregullsitë e përcaktuara dhe në aktvendim do të përcaktojnë masat dhe aktivitetet përkatëse që duhet të merren për të kapërcyer situatën e krijuar, si dhe do të përcaktojnë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë për të hequr shkaqet e gjendjes së krijuar.

(4) Kundër aktvendimit të inspektorëve sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni mund të deklarohet ankesë në përputhje me rregulloret e mbikëqyrjes inspektuese.

(5) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes sipas paragrafit (1) të këtij neni, inspektorët kanë të drejtë të ndërmarin masa të tjera të përcaktuara me rregulloret e mjedisit jetësor dhe rregulloret për mbikëqyrje inspektuese, si dhe rregulloret për veprimtari komunale në situatat sipas paragrafit (2) të këtij neni.

#### **Neni 45**

##### **Fushëveprimi i mbikëqyrjes së organit profesional**

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes në përputhje me nenin 19 të këtij ligji, organi profesional kryen inspektim dhe kontroll të të dhënave dhe dokumenteve që janë baza për mbajtjen e evidencës dhe përgatitjen e raporteve.

(2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes mbi kompensimin e llogaritur dhe të paguar sipas nenit 35 të këtij ligji, organi profesional kryen inspektim dhe kontroll:

1) nëse prodhuesi i cili është i obliguar të paguajë kompensim për menaxhimin e mbeturinave nga paketimi, e llogarit dhe paguan kompensimin në afatin e përcaktuar, si dhe nëse i plotëson kushtet për kthim të kompensimit të paguar (neni 35 të këtij ligji);

2) nëse kompensimi për menaxhimin e mbeturinave nga paketimi llogaritet dhe paguhet në kohë dhe drejtë dhe nëse mban dhe ruan evidencë të rregullt dhe të saktë të kompensimit të llogaritur dhe paguar (neni 36 të këtij ligji)

3) nëse prodhuesit i plotësojnë kushtet për lirim nga pagesa e kompensimit të përmendur në nenin 37 të këtij ligji.

(3) Për mbikëqyrjen dhe kontrollin e kryer sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, personi zyrtar i organit profesional përgatit raport të cilin e dorëzon te subjekti i mbikëqyrjes.

(4) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, organi sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni përcakton që subjektet e mbikëqyrjes nuk i përmbahen kërkesave të këtij ligji, me aktvendim do të përcaktojë masat dhe aktivitetet përkatëse që duhet të merren për të kapërcyer situatën e krijuar, si dhe do të përcaktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë për të hequr shkaqet e gjendjes së krijuar.

(5) Kundër aktvendimit sipas paragrafit (4) të këtij neni mund të deklarohet ankesë në përputhje me rregulloret për mbikëqyrje inspektuese.

(6) Nëse subjektet sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, nuk veprojnë në përputhje me aktvendimin e organit profesional dhe nuk heqin arsyet për gjendjen e krijuar të përcaktuara me aktvendimin, organi profesional do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje te organi kompetent i kundërvajtjes.

## **Neni 46**

### **Fushëveprimi i mbikëqyrjes së Inspektorit shtetëror të tregut**

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes nga fushëveprimi i tij, inspektori shtetëror i tregut kryen inspektim dhe kontroll:

1) nëse qeset e biodegradueshme për mbajtjen e mallrave janë lëshuar në treg në përputhje me nenin 10 të këtij ligji;

2) nëse në vendin e shitjes mbahet evidencë në bazë tremujore për numrin e qeseve të shitura dhe me shumën e përgjithshme të fituar nga kompensimi i qeseve të shitura veprohet në përputhje me nenin 10 paragrafi (4) të këtij ligji;

3) nëse të dhënat nga evidenca në bazë tremujore të numrit të qeseve të shitura paraqiten te organi profesional (neni 10 paragrafi (5) të këtij ligji);

4) nëse paketimi që prodhohet dhe/ose lëshohet në treg është në përputhje me kërkesat për nivelin e përqendrimit të metaleve të rënda të përmendura në nenin 14 të këtij ligji;

5) nëse dërgesa e paketimit e lëshuar në treg posedon të dhëna se janë përmbushur kërkesat për përqendrim e metaleve të rënda (neni 14 paragrafi (2) të këtij ligji);

6) nëse mbahen kontrole për nivelin e pranisë së metaleve të rënda në paketim, dhe nëse mbahet evidencë dhe dorëzohet raport te organ profesional në përputhje me nenin 14 paragrafët (4), (5) dhe (7) të këtij ligji;

7) nëse paketimi i lëshuar në treg është shënuar dhe identifikuar në përputhje me nenin 16 të këtij ligji;

8) nëse prodhuesi i informon tregtarët dhe shfrytëzuesit e fundit në mënyrë përkatëse për cilësitë e rëndësishme të produktit dhe paketimit të tij në pikëpamje të materieve dhe substancave të rrezikshme dhe të dëmshme që ato përmbajnë dhe për mënyrën e veprimit ndaj mbeturinave nga paketimi (neni 24 paragrafi (1) të këtij ligji);

9) nëse prodhuesi për paketimin që ka lëshuar në treg posedon të dhëna për sasinë e metaleve të rënda nga i cili prodhohet paketimi i cili lëshohet në treg, për secilin lloj të materialit nga i cili prodhohet paketimi, (neni 24 paragrafi (2) të këtij ligji);

10) nëse prodhuesi organizon fushata për informimin e shfrytëzuesve të fundit dhe ngritjen e vetëdijes publike (neni 24 paragrafi (3) të këtij ligji);

11) nëse prodhuesi informon shfrytëzuesit e fundit për pasojat negative për mjedisin jetësor nga konsumi i tepërt i qeseve plastike (neni 24 paragrafi (4) të këtij ligji) dhe

12) nëse prodhuesi i cili ka vendosur të vendosë dorëzani për produktet e tij të paketuara vepron në përputhje me nenin 33 të këtij ligji.

## Neni 47

### Miratimi i aktvendimeve nga Inspektori Shtetëror i Tregut

- (1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori shtetëror i tregut me aktvendim:
- 1) do t'i detyrojë prodhuesit dhe tregtarët të tërheqin nga tregu qese biodegraduese për bartjen e mallrave që nuk i përmbushin kërkesat sipas nenit 10 të këtij ligji;
  - 2) do t'i detyrojë tregtarët në pikën e shitjes të mbajnë regjistër në bazë tremujore të numrit të qeseve të shitura në pikën e shitjes dhe me shumën e përgjithshme të fituar nga kompensimi i qeseve të shitura të veprojnë në përputhje me nenin 10 paragrafi (4) të këtij ligji;
  - 3) do t'i detyrojë tregtarët të raportojnë të dhënat nga regjistrat në bazë tremujore të numrit të qeseve të shitura tek organi profesional (neni 10 paragrafi (5) të këtij ligji);
  - 4) do t'i detyrojë prodhuesit dhe furnizuesit e materialeve të paketimit t'i tërheqin nga tregu nëse prodhojnë dhe / ose lëshojnë në treg paketimet që nuk janë në përputhje me kërkesat për nivelin e përqendrimit të metaleve të rënda sipas nenit 14 të këtij ligji;
  - 5) do t'i detyrojë prodhuesit të kryejnë rregullisht kontrole për praninë e niveleve të metaleve të rënda në paketimet, si dhe të mbajnë shënime dhe të dorëzohet raport te organi profesional në përputhje me nenin 14 paragrafët (4), (5), dhe (7) të këtij ligji.
  - 6) do t'i detyrojë prodhuesit të shënojnë paketimet në përputhje me nenin 16 të këtij ligji;
  - 7) do t'i detyrojë prodhuesit të informojnë tregtarët dhe shfrytëzuesit e fundit për vetitë e rëndësishme të produktit dhe paketimit të tij në pikëpamje të materieve të rrezikshme dhe të dëmshme dhe substancave që ato i përmbajnë dhe për mënyrën e veprimit ndaj mbeturinave nga paketimi (neni 24 paragrafi (1) i këtij ligji);
  - 8) do t'i detyrojë prodhuesit për paketimin që e hedh në treg të sigurojë të dhëna për sasinë e metaleve të rënda nga të cilat prodhohet paketimi, për secilin lloj të materialit nga i cili prodhohet paketimi (neni 24 paragrafi (2) të këtij ligji);
  - 9) do t'i detyrojë prodhuesit të organizojnë fushata për informimin e shfrytëzuesve të fundit dhe ngritjen e vetëdijes publike (neni 24 paragrafi (3) të këtij ligji);
  - 10) do t'i detyrojë prodhuesit e qeseve plastike në mënyrë të duhur t'i informojnë shfrytëzuesit e fundit për pasojat negative për mjedisin jetësor nga konsumi i tepërt i qeseve plastike (neni 24 paragrafi (4) të këtij ligji), dhe
  - 11) do t'i detyrojë prodhuesit të cilët kanë vendosur dorëzani për produktet e tyre të paketuara të veprojnë në përputhje me nenin 33 të këtij ligji.
  - 12) nëse prodhuesi i cili ka vendosur të vendosë dorëzani për produktet e tij të paketuara vepron në përputhje me nenin 33 të këtij ligji.
- (2) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori shtetëror i tregut konstaton se subjektet e mbikëqyrjes nuk i janë përmbajtur kërkesave të këtij ligji, me procesverbal do t'i konstatojë parregullsitë e përcaktuara dhe me aktvendim do të përcaktojë masat dhe aktivitetet e duhura që duhet të ndërmerren për tejkalimin e situatës së krijuar si dhe do të caktojë afat që nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë për të larguar shkaqet për gjendjen e krijuar.
- (3) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori shtetëror i tregut subjekteve të mbikëqyrjes do t'u përcaktojë ndalesë të përkohshme për kryerjen e veprimtarisë e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 15 ditë, për parregullsitë e përcaktuara sipas nenit (1) pikat 4), 6) dhe 7) të këtij neni.
- (4) Kundër aktvendimit të inspektorit shtetëror të tregut mund të bëhet ankesë në përputhje me rregulloret për mbikëqyrjen inspektuese.
- (5) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes sipas paragrafit (1) të këtij neni, inspektori shtetëror i tregut ka të drejtë të ndërmarrë edhe masa të tjera të përcaktuara me rregulloret për inspektoratin shtetëror të tregut dhe rregulloret për mbikëqyrjen inspektuese.

## Neni 48

### Zbatimi i dispozitave dhe ligjeve të tjera në mbikëqyrjen inspektuese

Në procedurën gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese e cila zbatohet në përputhje me këtë ligj, zbatohen në mënyrë përkatëse dispozitat e rregulloreve të mbikëqyrjes inspektuese, rregulloreve për mjedisin jetësor, rregulloreve për menaxhimin e mbeturinave dhe rregulloreve për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesit për menaxhimin e rrjedhave të veçanta të mbeturinave, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

## VII. DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

## Neni 49

### Sanksione kundërvajtëse nga kategoria e parë

(1) Gjobë në vlerë prej 9,000 deri në 10,000 euro në kundërvlerë denari për tregtarët mikro, nga 18,000 në 20,000 euro në kundërvlerë të denarë për tregtarët e vegjël, nga 53,000 në 59,000 euro në kundërvlerë denari për tregtarët e mesëm dhe nga 89,000 në 98,000 euro në kundërvlerë denari për tregtarët e mëdhenj do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

1) të dhënat nga regjistrat në bazë tremujore për numrin e qeseve të shitura nuk i paraqet tek organi profesional në përputhje me nenin 10 paragrafi (5) të këtij ligji;

2) nuk emëron përfaqësues të autorizuar në përputhje me nenin 18 të këtij ligji;

3) nuk siguron pranim kthyes të paketimit të shitur, të grupuar dhe të transportuar në përputhje me nenin 20 të këtij ligji;

4) nuk paguan kompensim paushall në përputhje me nenin 22 paragrafi (2) të këtij ligji;

5) nuk i informon në mënyrë adekuate tregtarët dhe shfrytëzuesit e fundit për vetitë e rëndësishme të produktit dhe paketimit të tij në pikëpamje të materieve të rrezikshme dhe të dëmshme dhe substancave që ato i përmbajnë dhe për mënyrën e veprimit ndaj mbeturinave nga paketimi (neni 24 paragrafi (1) i këtij ligji);

6) nuk ka të dhëna për llojin e materialit dhe sasinë e metaleve të rënda nga të cilat është i prodhuar paketimi që është lëshohet në treg (neni 24 paragrafi (2) të këtij ligji);

7) nuk organizon fushata për informimin dhe ngritjen e vetëdijes publike në përputhje me nenin 24 paragrafi (3) të këtij ligji;

8) nuk i informon shfrytëzuesit e fundit për pasojat negative për mjedisin jetësor nga konsumi i tepërt i qeseve plastike për bartjen e mallrave (neni 24 paragrafi (4) të këtij ligji);

9) nuk i përmbush detyrimet për kthimin e pranimit të paketimit në përputhje me nenin 27 paragrafi (1) të këtij ligji;

10) nuk i dorëzon mbeturinat e grumbulluara nga paketimi në përputhje me nenin 27 paragrafi (3) të këtij ligji;

11) nuk mundëson marrjen e mbeturinave të mbledhura nga paketimi pa kompensim (neni 28 paragrafi (3) të këtij ligji);

12) nuk mban evidencë për sasinë e marra të mbeturinave nga paketimi sipas llojit dhe kategorisë dhe nuk i vë ato në dispozicion të organeve kompetente të inspektimit në çdo kohë (neni 29 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji);

13) fut dhe paraqet të dhëna të pasakta në regjistrat për sasinë e mbeturinave të marra nga paketimi (neni 29 paragrafi (3) të këtij ligji);

14) nuk i dorëzon mbeturinat e grumbulluara nga paketimi në mënyrën e përcaktuar në nenin 30 paragrafi (3) të këtij ligji;

15) mbeturinat nga paketimi nuk i grumbullon, ruan dhe dorëzon në përputhje me nenin 31 të këtij ligji;

16) nuk e shënon saktë dhe qartë paketimin i cili është i përfshirë me sistemin e dorëzimit, nuk organizon kthim të pranimit dhe nuk i përcakton kushtet për paketimin i cili është i pranueshëm për sistemin e dorëzimit (neni 33 paragrafi (3) të këtij ligji);

17) në afat të përcaktuar te organi profesional nuk i regjistron produktet që janë të përfshira në sistemin e dorëzarisë dhe shumën e depozitës sipas njësisë së paketimit (neni 33 paragrafi (4) të këtij ligji);

18) nuk e njofton organin profesional në afat të përcaktuar për qëllimin e ndërprerjes së sistemit të dorëzarisë (neni 33 paragrafi (7) të këtij ligji);

19) nuk e shënon vendin ku kryhet kthimi i pranimit të paketimit brenda sistemit të lirimimit me kusht (neni 33 paragrafi (10) të këtij ligji);

20) nuk e kthen paketimin në sistemin e dorëzarisë pa ndryshime në përputhje me nenin 33 paragrafi (12) të këtij ligji, dhe

21) nuk e financon sistemin në tërësi të dorëzarisë te tregtari për paketimin e tij të përfshirë në sistemin e dorëzarisë (neni 33 paragrafi (13) të këtij ligji).

(2) Personit përgjegjës në personin juridik për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje të kryer në shumë prej 500 euro në kundërvlerë denari për mikrotregtar, nga 1000 euro në kundërvlerë denari për tregtar të vogël, nga 3,000 euro në kundërvlerë denari për tregtar të mesëm dhe 5,000 euro në kundërvlerë denari për tregtar të madh.

(3) Gjobë në vlerë prej 200 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit fizik për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes sipas paragrafit (1) të këtij neni, organi kundërvajtës, mund t'i shqiptojë sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të veprimtarisë.

(5) Personit përgjegjës sipas paragrafit (2) të këtij neni, organi kundërvajtës mund t'i shqiptojë sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të veprimtarisë.

(6) Organi kundërvajtës kompetent për shqiptimin e sanksioneve kundërvajtësi sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni është gjykata kompetente, kurse organi kundërvajtës kompetent për shqiptimin e sanksioneve kundërvajtëse sipas paragrafit (3) të këtij neni është Komisioni kundërvajtës i formuar në përputhje me Ligjin e Mjedisit Jetësor (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni kundërvajtës).

## **Neni 50**

### **Sanksione kundërvajtëse nga kategoria e dytë**

(1) Gjobë në vlerë prej 13.000 deri 14.000 eurove në kundërvlerë denari për mikro tregtarë, prej 25.000 deri 28.000 euro në kundërvlerë denari për tregtarët e vegjël, prej 76.000 deri 84.000 euro në kundërvlerë denari për tregtarët e mesëm dhe prej 126.000 deri 140.000 euro në kundërvlerë denari për tregtarët e mëdhenj do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse:

1) lëshon në treg qese plastike për bartjen e mallrave në kundërshtim me nenin 10 paragrafët (1), (3) dhe (4)

2) në pikën e shitjes nuk mbanë evidencë në bazë tremujore për numrin e qeseve të shitura dhe me shumën e përgjithshme të fituar nga kompensimi i qeseve të shitura nuk vepron në përputhje me nenin 10 paragrafi (4) të këtij ligji;

3) prodhon dhe/ ose lëshon në treg paketime që nuk i përmbushin kërkesat në raport me prodhimin dhe përmbajtjen e paketimit (neni 11 të këtij ligji);

4) prodhon dhe/ ose lëshon në treg paketime që nuk janë të përpunuara në përputhje me kërkesat sipas nenit 12 të këtij ligji;

5) prodhon dhe/ ose lëshon në treg paketime që nuk janë të përpunuara në përputhje me kërkesat në pikëpamje të përshtatshmërisë së paketimit për përpunim (neni 13 të këtij ligji);

6) ndaj dërgesës së paketimit që e lëshon në treg nuk ka të dhëna se janë të përmbushura kërkesat për përqendrim të metaleve të rënda (neni 14 paragrafi (2) të këtij ligji);

7) nuk mban kontrolle për praninë e metaleve të rënda në paketimet dhe nuk mban shënime dhe nuk dorëzon raport vjetor për veprimin me ato paketim te organi profesional në përputhje me nenin 12 paragrafët (4), (5) dhe (7) të këtij ligji;

8) prodhon dhe/ ose lëshon në treg paketime që nuk janë të prodhuara në përputhje me standardet kombëtare dhe europiane për prodhim të paketimit ( neni 15 të këtij ligji);

9) nuk e identifikon dhe shënon paketimin me shenjë përkatëse në përputhje me nenin 16 të këtij ligji;

10) nuk regjistrohet si prodhuese te organi profesional, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji;

11) nuk mban regjistër në formë të shkruar dhe elektronike për llojin dhe sasinë e paketimeve të lëshuara në treg në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) të këtij ligji dhe nuk i ruan të dhënat në regjistrin deri në afatin e caktuar;

12) nuk i dorëzon raport vjetor organit profesional në afatin e caktuar për llojin dhe sasinë e paketimit që e ka lëshuar në treg (neni 19 paragrafi (2) të këtij ligji);

13) nuk përgatit specifikim të prodhimit me informacione për peshën e paketimit (neni 19 paragrafi (3) të këtij ligji);

14) nuk mban shënime mujore dhe vjetore bazuar në specifikimit të prodhimit për paketimin e përgjithshëm që e ka lëshuar në treg (neni 19 paragrafi (4) të këtij ligji);

15) nuk mban shënime për sasinë e mbeturinave nga paketime që është pranuar përsëri, sipas kategorisë, në vitin e dhënë dhe për dëshminë për mbeturinat e dorëzuara nga paketime të grumbulluesit ose recikluesit ( neni 19 paragrafi (5) të këtij ligji);

16) nuk dorëzon raport tremujor te vepruesi kolektiv ( neni 19 paragrafi (9) të këtij ligji);

17) nuk i përcakton qëllimet vjetore për grumbullimin, riciklimin dhe përpunimin sipas kategorisë së mbeturinave në kilogramë afatin e caktuar (neni 21 paragrafi (6) të këtij ligji)

18) nuk siguron financim të shpenzimeve për aktivitetet sipas nenit 22 paragrafi (1) të këtij ligji;

19) nuk siguron garanci financiare për zbatimin e detyrimeve për grumbullimin, trajtimin dhe përpunimin në përputhje me nenin 23 të këtij ligji;

20) nuk siguron përmbushjen e detyrimeve dhe qëllimeve të këtij ligji nëpërmjet kthimit, mbledhjes dhe përpunimit në shpenzim të tij në përputhje me nenin 25 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji;

21) nuk ka lidhur marrëveshje për ndërmarrjen e detyrimeve për veprim ndaj mbeturinave nga paketime (neni 25 paragrafi (3) të këtij ligji);

22) nuk regjistrohet si prodhues i vogël, nuk mban evidencë dhe nuk dorëzon raporte ( neni 26 paragrafi (2) të këtij ligji);

23) me qëllim dorëzon të dhëna të pasakta gjatë përcaktimit si prodhues i vogël ( neni 26 paragrafi (3) të këtij ligji);

24) nuk kryen pagesë të dorëzansisë ndaj tregtarëve dhe/ose shfrytëzuesve të fundit në afat të përcaktuar pasi e ka ndërprerë sistemin e dorëzansisë (neni 33 paragrafi (8) të këtij ligji);

25) nuk i kryen pagesë të dorëzansisë shfrytëzuesit e fundit (neni 33 paragrafi (11) të këtij ligji)

26) me qëllim tregon të dhëna të pasakta për shkak të lirimit nga pagesa e kompensimit sipas nenit 37 të këtij ligji ose kthim të kompensimit të paguar për mallin e paketuar sipas nenit 35 paragrafi (1) të këtij ligji dhe

27) kompensimin për menaxhim të mbeturinave nga paketime nuk e llogarit dhe nuk e paguan në kohë dhe me rregull dhe nuk e mban, ruan regjistrin të rregulluar dhe të saktë për kompensimin e llogaritur dhe të paguar ( neni 36 paragrafi (1) të këtij ligji).

(2) Personit përgjegjës në personin juridik për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje të kryer në shumë prej 700 euro në kundërvlerë denari për mirko tregtar, nga 1,500 euro në kundërvlerë të denarit për tregtar të vogël, nga 4,000 euro në kundërvlerë denari për tregtar të mesëm dhe 7,000 euro në kundërvlerë denari për tregtar të madh.

(3) Gjobë në vlerë prej 250 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit fizik për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes sipas paragrafit (1) të këtij neni, organi i kundërvajtjes mund t'i shqiptojë sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të veprimtarisë.

(5) Personit përgjegjës sipas paragrafit (2) të këtij neni, organi kundërvajtës mund t'i shqiptojë sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të veprimtarisë.

(6) Organi kundërvajtës kompetent për shqiptimin e sanksioneve kundërvajtëse sipas paragrafëve (1) dhe (2) nga ky nen është gjykata kompetente, kurse organ kundërvajtës kompetent për shqiptimin e sanksioneve sipas paragrafit (3) të këtij neni është Komisioni kundërvajtës.

## **Neni 51**

### **Sanksionet kundërvajtëse nga kategoria e tretë**

(1) Gjobë në vlerë prej 18,000 nga 20,000 euro në kundërvlerë denari për mikro tregtarët, nga 36,000 në 40,000 euro në kundërvlerë denari për tregtarët e vegjël, nga 110,000 në 120,000 euro në kundërvlerë denari për tregtarët e mesëm dhe nga 180,000 në 200,000 euro në kundërvlerë denari për tregtarët e mëdhenj do t'i shqiptohet kundërvajtje personit juridik nëse:

1) prodhon dhe/ ose lëshon në treg paketimi që i tejkalojnë kufijtë e lejuar të përqendrimit të metaleve të rënda sipas nenit 14 paragrafi (1) të këtij ligji;

2) nuk siguron realizimin e qëllimeve kombëtare për grumbullimin, përpunimin dhe riciklimin në përputhje me nenin 21 paragrafi (1) të këtij ligji dhe

3) nuk paguan kompensim për menaxhim të mbeturinave nga paketimi në afat të përcaktuar në përputhje me nenin 35 paragrafët (1) dhe (6) të këtij ligji.

(2) Personit përgjegjës në personin juridik për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje të kryer në vlerë prej 1.000 euro në kundërvlerë denari për mikro tregtar, 2.000 euro në kundërvlerë denari për tregtar të vogël, 6.000 euro në kundërvlerë denari për tregtar të mesëm dhe 10.000 euro në kundërvlerë denari për tregtar të madh.

(3) Gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit fizik për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Për kryesit e kundërvajtjes sipas paragrafit (1) të këtij neni, organi kundërvajtës mund t'i shqiptojë sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerjen e veprimtarisë.

(5) Personit përgjegjës sipas paragrafit (2) të këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i shqiptojë sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerjen e detyrës.

(6) Organ kundërvajtës kompetent për shqiptimin e sanksioneve kundërvajtëse nga ky nen është gjykata komente.

## **Neni 52**

### **Procedura për shlyerje dhe marrëveshje**

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 49 të këtij ligji, inspektorët kompetent të autorizuar me këtë ligj janë të detyruar që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojnë procedurë për shlyerje me dhënien e urdhërpagesës për kundërvajtje para se të parashtrojnë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse

(2) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 50 dhe 51 të këtij ligji, inspektorët kompetent të autorizuar me këtë ligj janë të detyruar që kryesit të kundërvajtjes t'ia vazhdojnë procedurën për marrëveshje para se të parashtrojnë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.

(3) Procedurat e shlyerjes dhe marrëveshjes do të udhëhiqen në përputhje me dispozitat e Ligjit të Kundërvajtjes dhe Ligjit të Mjedisit Jetësor.

(4) Ministri, i cili udhëheq organin për mjedisin jetësor, përshkruan formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni.

## **Neni 53**

### **Udhëheqja e procedurës kundërvajtëse**

Procedura e kundërvajtjes udhëhiqet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Kundërvajtjes dhe Ligjit të Mjedisit Jetësor.

## **VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRMBYLLËSE**

### **Neni 54**

#### **Afatet për zbatim**

- (1) Prodhuesit të cilët për herë të parë lëshojnë në treg ose importojnë si shfrytëzues të fundit në Republikën e Maqedonisë së Veriut mallra të paketuara, janë të detyruar të regjistrohen në përputhje me nenet 17 dhe 18 të këtij ligji, më së voni më 31 mars të vitit 2022.
- (2) Prodhuesi, regjistrin sipas nenit 19, paragrafi (1) të këtij ligji, është i detyruar të fillojë ta mbajë nga 1 janari i vitit 2022.
- (3) Raportin e parë vjetor për llojin dhe sasinë e paketimit të lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas nenit 19 paragrafi (2) të këtij ligji, prodhuesi është i detyruar të dorëzojë më së voni më 31 mars të vitit 2023 për vitin 2022.
- (4) Raportin e parë tremujor të vepruesi kolektiv sipas nenit 19 paragrafi (9) të këtij ligji, prodhuesi është i detyruar ta dorëzojë më së voni deri më 15 prill të vitit 2022.

### **Neni 55**

#### **Miratimi i rregulloreve nënligjore**

- (1) Rregulloret nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
- (2) Deri në ditën e hyrjes në fuqi të rregulloreve nënligjore sipas paragrafit (1) të këtij neni do të zbatohen rregulloret nënligjore ekzistuese.

### **Neni 56**

#### **Zbatim i shtyrë**

- (1) Dispozitat sipas nenit 10 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 dhjetori 2021.
- (2) Dispozita sipas nenit 34 paragrafi (7) të këtij ligji do të fillojë të zbatohet pas pranimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Europian.
- (3) Dispozita sipas nenit 35 të këtij ligji do të fillojë të zbatohet nga 1 janari i vitit 2022.

### **Neni 57**

#### **Ndalimi i vlefshmërisë**

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ndalon të vlejë Ligji i Menaxhimit të Paketimit dhe të Mbeturinave nga Paketimi ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 161/09,17/11, 47/11,136/11 6/12, 39/12, 163/13, 146/15 dhe 39/16).

### **Neni 58**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga shpallja në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".